



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Inputi për Raportin e Progresit**

**Maj 2013**  
**PRISHTINË**

## Contents

|   |           |
|---|-----------|
| <b>LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE .....</b>   | <b>3</b>  |
| <b>1. KRITERET POLITIKE .....</b>   | <b>7</b>  |
| 1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT .....   | 7         |
| 1.1.1 Institucionet .....   | 7         |
| 1.1.2 Parlamenti/Zgjedhjet .....  | 7         |
| 1.1.3 Administrata Publike .....  | 7         |
| 1.1.4 Sistemi Gjyqësor .....  | 8         |
| 1.1.5 Lufta Kundër Korrupsionit .....   | 10        |
| 1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE .....                                   | 10        |
| 1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve .....                                  | 10        |
| 1.2.2. Të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e pakicave .....              | 12        |
| 1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE .....                                       | 13        |
| <b>2. KRITERET EKONOMIKE .....</b>  | <b>13</b> |
| 2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SE TREGUT .....  | 13        |
| 2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike .....                             | 14        |
| 2.1.2. Raportimi në lidhje me politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese ..... | 16        |
| 2.1.3. Ndëroeprimi i forcave të tregut .....  | 17        |
| 2.1.4. Sektori financiar .....  | 18        |
| 2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT .....       | 20        |
| 2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik .....  | 20        |
| 2.2.2. Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve .....  | 21        |
| 2.2.3. Ndikimi i shtetit në konkurrencë/konkurueshmëri .....                                  | 22        |
| 2.2.4. Integrimi tregtar .....  | 23        |
| <b>3. STANDARDET EVROPIANE .....</b>  | <b>23</b> |
| 3.1. TREGU I BRENSHËM .....   | 23        |
| 3.1.1 Lëvizja e Lirë e Mallrave .....   | 23        |
| 3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit .....   | 26        |
| 3.1.3. Doganat dhe Tatimet .....  | 27        |
| a. Doganat .....  | 27        |
| b. Tatimet .....  | 28        |
| 3.1.4. Konkurrenca .....  | 29        |
| 3.1.5. Prokurimi Publik .....   | 29        |
| 3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit .....                     | 30        |
| 3.1.7. Punësimi dhe politikat sociale .....   | 31        |
| 3.1.8. Arsimi dhe Hulumtimi .....   | 33        |
| 3.2. POLITIKAT SEKTORIALE .....   | 34        |
| 3.2.1. Industria dhe NVM-të .....   | 34        |
| 3.2.2. Bujqësia dhe Peshkataria .....   | 34        |
| 3.2.3. Mjedisi .....  | 37        |
| 3.2.4. Politika e Transportit .....   | 39        |
| 3.2.5. Energjia, përfshirë sigurinë bërthamore .....  | 41        |
| 3.2.6. Shoqëria Informative dhe Media .....   | 42        |
| 3.2.7. Kontrolli Financiar .....  | 44        |
| 3.2.8. Statistikat .....  | 44        |
| 3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA .....   | 45        |
| 3.3.1. Azili, migrimi, politika e vizave dhe sundimi i ligjit .....                           | 45        |
| 3.3.2. Shpërlarja e parave .....  | 46        |

|  |           |
|--|-----------|
| 3.3.3. Policia dhe Lufta Kundër Krimin të Organizuar .....   | 47        |
| 3.3.4. Mbrojtja e të dhënave Personale.....  | 49        |
| Aneksi 1. Lista e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës per periudhen raportuese: .....   | 50        |
| Aneksi 2: Projektligjet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës për periudhën raportuese:..... | 53        |
| Aneksi 3: Legjislacioni sekondar qe eshte miratuar ne Qeverine e Republikes se Kosoves per periudhen raportuese.....   | 57        |
| Aneksi IV - Strategjite dhe planet e veprimit qe jane miratuar ne Qeverine e Republikes se Kosoves per periudhen raportuese:.....                                      | 59        |
| <b>Aneks 5: Udhezimet Administrative te aprovuara gjate periudhes raportuese ne fushen e arsimit: ..</b>   | <b>59</b> |

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

|       |   |
|-------|---|
| AAP   | Arsimi dhe Aftësimi Profesional   |
| ABGJ  | Agjencia për Barazi Gjinore   |
| AGPK  | Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Kosovës  |
| AKB   | Aleanca Kosovare e Bizneseve  |
| AKK   | Agjencia Kundër Korrupsionit  |
| AKK   | Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare  |
| AKP   | Agjencia Kosovare e Privatizimit  |
| AKS   | Agjencia Kosovare për Standarde   |
| AMPM  | Antemortum – Postmortum   |
| ANP   | Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës   |
| ANVM  | Agjencioni për Ndërrmarjet e Vogla dhe të Mesme   |
| APIK  | Agjencioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë   |
| APK   | Agjencioni Pyjor i Kosovës  |
| APP   | Agjencia për Prokurim Publik  |
| ARBK  | Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë  |
| ART   | Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit   |
| ATK   | Administrata Tatimore e Kosovës   |
| AUV   | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë  |
| BB    | Banka Botërore  |
| BE    | Bashkimi Evropian   |
| BPV   | Bruto Produkti Vendor   |
| BQK   | Banka Qendrore e Kosovës  |
| CEFTA | Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore  |
| DAK   | Drejtoria e Akreditimit të Kosovës  |
| DASHC | Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil   |
| DBJN  | Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar   |
| DK    | Doganat e Kosovës   |
| DMNV  | Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave   |
| DMRAP | Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike                           |
| DPI   | Departamenti i Pronësisë Intelektuale   |
| ECAA  | Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit ( <i>European Common Aviation Area</i> )     |
| ESK   | Enti i Statistikave të Kosovës  |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë                              |
| FADN  | Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitetin e Fermave ( <i>Farm Accountancy Data Network</i> ) |
| FET   | Fondacioni European për Trajnime  |
| FMN   | Fondi Monetar Ndërkombëtar  |
| GDDS  | General Data Dissemination Standard   |
| GND   | Grupi Ndërmintor për Decentralizim  |
| GP    | Grupi Punues  |
| IÇK   | Indeksi i Çmimeve të Konsumit   |
| IFS   | Institucionet Ndërkombëtare Financiare  |
| IGJK  | Instituti Gjyqësor i Kosovës  |
| IHH   | Indeksi Herfindalh - Hirschman  |
| IKAP  | Instituti Kosovar për Administratë Publike  |
| IOM   | Organizata ndërkombëtare e Migrimit ( <i>International Organization for Migration</i> )   |

|        |   |
|--------|---|
| IPA    | Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimit                                  |
| IPN    | Instituti për Produktet e Ndërtimit   |
| KE     | Komisioni Evropian  |
| KEK    | Korporata Energjetike e Kosovës   |
| KGJK   | Këshilli Gjyqësor i Kosovës   |
| KK     | Kuvendi/et Komunal/e  |
| KKDFE  | Kompania Kosovare e Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike            |
| KKK    | Korniza e Kurrikulumi të Kosovës  |
| KNRAP  | Komiteti Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike                        |
| KOSTT  | Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës |
| KPGJP  | Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial                                    |
| KPGjP  | Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial                                     |
| KPK    | Komisioni Prokurorial i Kosoves   |
| KPMM   | Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve                                  |
| KQP    | Komisioni Qeveritar për Privatizim  |
| KQPZh  | Komisioni Qendror për Persona të Zhdukur  |
| KQZ    | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  |
| KRPP   | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik                                       |
| MAP    | Ministria e Administratës Publike   |
| MAPL   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                                    |
| MASHT  | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë                                  |
| MBPZhR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural                          |
| MD     | Ministria e Drejtësisë  |
| MEK    | Menaxhimi i Financave të Kontrollit   |
| MF     | Ministria e Financave   |
| MFSK   | Ministria e Forcës dhe Sigurisë   |
| MI     | Ministria e Infrastrukturës   |
| MIE    | Ministria e Integritetit Evropian   |
| MIK    | Menaxhimi i Integruar i Kufirit   |
| MKK    | Ministria për Komunitete dhe Kthim  |
| MKRS   | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  |
| ML     | Ministritë e Linjës   |
| MM     | Memorandum Mirëkuptimi  |
| MMPH   | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                                 |
| MPB    | Ministria e Punëve të Brendshme   |
| MPF    | Monitorimi i Punës së Fëmijëve  |
| MPJ    | Ministria e Punëve të Jashtme   |
| MPMS   | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  |
| MSH    | Ministria e Shëndetësisë  |
| MTI    | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë   |
| MZhE   | Ministria e Zhvillimit Ekonomik   |
| NjDNjK | Njësia për të Drejtat e Njeriut të Komunave                                     |
| NjIF   | Njësia e Inteligjencës Financiare   |
| NP     | Ndërmarrje Publike  |
| NSH    | Ndërmarrje Shoqërore  |
| NVM    | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme  |
| OEAK   | Oda Ekonomik Amerikane e Kosovës  |
| OEK    | Oda Ekonomike e Kosovës   |

|              |   |
|--------------|---|
| OJQ          | Organizatat Jo-Qeveritare   |
| OSBE         | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë   |
| OSHP         | Organi Shqyrtues i Prokurimit   |
| PFAL         | Programi Fillestar për Arsimim Ligjor   |
| PK           | Policia e Kosovës   |
| PKK          | Pika e Kalimit Kufitar  |
| Projekti RAE | Projekti për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit  |
| PSAK         | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë  |
| PSH          | Prokuroria e Shtetit  |
| PSO          | Procedurat Standarde të Operimit  |
| PTB          | Projekti Tam/Bas  |
| PTK          | Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës   |
| PVAL         | Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor   |
| PVPE         | Plani i Veprimit për Partneritet Evropian   |
| PVPQ         | Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës   |
| PZhBV        | Personat e Zhvendosur Brenda Vendit   |
| QAP          | Qendra për Aftësim Profesional  |
| RAP          | Reforma e Administratës Publike   |
| RTK          | Radio Televizioni i Kosovës   |
| SEECCEL      | South East European Center for Entrepreneurial Learning   |
| SEMSF        | Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik  |
| ShKCAK       | Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës   |
| ShKK         | Shërbimi Korrektues i Kosovës   |
| ShPK         | Shërbimi Policor i Kosovës  |
| SISh         | Sistemi Informimin Shëndetësor  |
| SKQZ         | Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve  |
| SMC          | Sistemi i Monitorimit të Cilësisë   |
| SMIL         | Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve  |
| SMP          | Staff Monitored Program   |
| SPVKK        | Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër-Korrupcion   |
| TAIEX        | Asistencë teknike dhe shkëmbim i informacionit ( <i>Technical Assistance and Information Exchange</i> )                                   |
| TVK          | Trupa e Vlerësimit për Standarde  |
| TVSH         | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar  |
| UA           | Udhëzim Administrativ   |
| UNDP         | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara ( <i>United Nations Development Programme</i> )  |
| UNHCR        | Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë ( <i>Office of the United Nations High Commissioner for Refugees</i> ) |
| USAID        | United States Agency for International Development  |
| ZAP          | Zyra e Auditorit të Përgjithshëm  |
| ZÇK          | Zyra për çështje të komuniteteve  |
| ZKK          | Zyra për Kthim dhe Komunitete   |
| ZKM          | Zyra e Kryeministrit  |
| ZPI          | Zyra për Pronësi Industriale  |
| ZQM          | Zyra për Qeverisje të Mirë  |
| ZRE          | Zyra e Rregullatorit të Energjisë   |
| ZRRUM        | Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina  |

## **Hyrje**

Ky raport përmban zhvillimet kryesore në Kosovë nga 1 shtatori 2012 deri në 31 prill 2013. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për t'i dorëzuar të dhënat për Raportin e Progresit, i cili do të publikohet në vjeshtën e këtij viti.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport fokusohen në arritjet e bëra karshi:

- Zbatimit të reformave;
- Zhvillimin e kapaciteteve legislative dhe administrative;
- Sfidat e identifikuara në Studimin e Fizibilitetit të Komisionit Evropian për Kosovën mbi MSA-në mes Kosovës dhe EU-së, Raportin e Progresit 2011 dhe Takimet e Dialogut të Procesit të Stabilizimit Asociimit dhe
- Zbatimin e prioriteteve të afat-shkurta dhe afat-mesme, përmes PVNMSA-së;

Struktura e të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit duke ofruar informata mbi tri fushat në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane.

# **1. KRITERET POLITIKE**

## **1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT**

### **1.1.1 Institucionet**

Me qëllim të përmirësimit të planifikimit strategjik dhe koordinimit të politikave, Qeveria e Kosovës me datën 5 Prill 2013 ka miratuar deklaratën e politikave afatmesme prioritare 2014-2016. Kjo deklaratë është hartuar duke marrë parasysh Kornizën Makrofikale 2014-2016 të lëshuar nga MF. Për më tepër, është harmonizuar Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2013 me Buxhetin Vjetor për vitin 2013.

Në vazhden e procesit të decentralizimit për Komunën e Mitrovicës Veriore, MAPL në bashkëpunim me Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV) kanë hartuar Planin Aksional 2013 për Funkcionalizimin e Plotë të ZAMV-së.

Me qëllim të adresimit të kriterit afatshkurtër për sigurimin e pavarësisë buxhetore dhe buxhetit të mjaftueshëm për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, më 13 dhjetor 2012 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Propozim-buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Buxheti për vitin 2013 për Avokatin e Popullit është rritur nga 636 000 €, sa ka qenë të ndara për vitin paraprak, në pak më shumë se 1 milion €. Shuma e re e ndarë hap mundësitë për rritje të stafit të këtij institucioni nga 48 punëtorë në 60.

### **1.1.2 Parlamenti/Zgjedhjet**

Liderët e partive politike janë dakorduar që Kosova të jetë rajon i vetëm elektoral si dhe kohëzgjatja e kampanjës elektorale të shkurtohet për gjysmë, pra nga një muaj në 15 ditë. Ligjit mbi Zgjedhje to t'i shtohen rekomandimet e ekspertëve të KE-së. Megjithatë, ende ka raste në pritje të zgjidhjeve, si lista e votuesve, pragu zgjedhor dhe votimi me kusht, raste të cilat si rrjedhojë janë duke e zgjatur procesin e reformës zgjedhore.

Sa i përket mashtrimit elektoral, Prokuroria Themelore e Republikës së Kosovës ka lëshuar 232 padi për mashtrime elektorale kundër 1456 personave.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) në bashkëpunim me Fondacionin Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale (IFES) është në proces të përgatitjes së strategjisë për ngritje të vetëdijes mbi implikimet që dalin nga mashtrimet elektorale.

### **1.1.3 Administrata Publike**

Në vazhden e avancimit të reformës së administratës publike, Qeveria e Republikës së Kosovës më datën 07 dhjetor 2012 ka miratuar rregulloren nr. 30/2012 për kushtet e kufizimit të së drejtës për grevë në shërbime të veçanta në shërbimin civil, rregulloren nr. 31/2012 për procedurat e përkujdesjes për nëpunësit civilë për shkak të paaftësisë fizike apo mendore ose problemeve shëndetësore. Ndërsa me datën 09 dhjetor 2012 është miratuar rregullorja nr.33/2012 për shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë.

Sa i përket implementimit të kornizës ligjore mbi shërbimin civil, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar rregulloret për organizim të brendshëm për institucionet në vijim:

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (07 dhjetor 2012 bazuar në vendimin nr. 12/107);
- Ministria e Integritimit Evropian (14 dhjetor 2012 bazuar në vendimin nr. 07/108);
- Ministria për Komunitete dhe Kthim (26 dhjetor 2012 bazuar në vendimin nr. 09/110);
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (30 janar 2013 bazuar në vendimin nr. 03/114);
- Ministria e Punëve të Jashtme (30 janar 2013 bazuar në vendimin nr. 04/114);



- Inspektorati i Tregut (27 mars 2013 bazuar në vendimin nr. 06/121).

Gjatë periudhës raportuese, IKAP me përkrahje të ofruar nga GIZ-i dhe Ministria e Integrimit Evropian kanë organizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të 41 zyrtarëve qeveritarë lidhur me harmonizimin e legjislacionit vendor me trupin legjislativ të BE-së, gjegjësisht *acquis communautaire*.

#### **1.1.4. Sistemi Gjyqësor**

Në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore të sistemit gjyqësor, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit institucional në fushën e sundimit të ligjit, Kuvendi i Kosovës më datën 20.12.2012 ka miratuar ligjin nr. 04/L-139 për procedurën përmbarimore ndërsa më datë 08.03.2013 ka miratuar ligjin nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Me qëllim të implementimit të ligjit për procedurën përmbarimore, MD ka hartuar udhëzimin administrativ për organizimin dhe dhënien e provimit për përmbarues.

Gjithashtu, në drejtim të implementimit të ligjeve kornizë të reformës gjyqësore, KGJK dhe KPK, kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar një reformim efiçent të reformës së re gjyqësore. KGJK dhe KPK, në dhjetor të vitit 2012/ janari 2013, kanë miratuar strukturën e re organizative të gjyqësorit respektivisht prokurorive, dhe kanë emëruar të gjithë gjyqtarët si dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore dhe ata të apelit. Janë caktuar dhe transferuar te gjithë gjyqtarët dhe prokurorët me gjithë stafin mbështetës nëpër gjykata dhe prokuroritë përkatëse. Në drejtim të reduktimit të lëndëve të grumbulluara, më datë 8 prill 2013, KGJK ka marrë vendim për themelimin e komisionit për rishikimin e strategjisë për reduktimin e lëndëve të vjetra.

Në shkurt 2013, KPK ka miratuar raportin vjetor të prokurorive të Kosovës. Sa i përket procesit të emërimit për gjyqtarë dhe prokurorë, në dhjetor 2012, KPK ka bërë dekretimin e 22 prokurorëve të rinj dhe 6 prokurorëve të komunitetit pakicë.

Me qëllim të sensibilizimit dhe inkurajimit të komunitetit pakicë, për të plotësuar vendet e lira për prokurorë, janë organizuar fushata vetëdijësuese në vendet e banuara me minoritete duke i informuar për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe plotësimin e kushteve për emërim për prokuror. Kampanjat janë lansuar në më 14 shkurt 2013 dhe janë mbajtur në Graçanicë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Novoberd, Ranillug, Partesh, Klllokot, Viti, Gjilan, Peja, Istog, Klina, Mamush, Prizeren. Fushatat do të vazhdojnë deri në qershor të vitit 2013.

Gjithashtu KPK është në proces të rekrutimit të 43 pozitave për staf mbështetës për prokurorë. Ndërsa me qëllim të mbështetjes së punës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe forcimit të bashkëpunimit me EULEX-in, KPK ka marrë vendim që gjatë muajit qershor 2013, të fillojnë procedurat e përzgjedhës dhe transferimit të pesë prokurorëve nga prokuroritë tjera në PSRK. Për më tepër gjatë periudhës raportuese KGJK ka rekrutuar 46 persona staf mbështetës për të gjitha nivelet e gjykatave.

Sa i përket masave disiplinore për prokurorë gjatë vitit 2012, KPK gjatë periudhës raportuese ka trajtuar 16 raste disiplinore ndaj prokurorëve, duke shqiptuar 12 vendime: 3 qortime, 3 pezullime, 1 hedhje e raportit, 2 masa për zvogëlimin e pagës prej 50% për 6 muaj, dy suspendime pa pagese, dhe 1 zvogëlim i pagës prej 50% për tre muaj. Ndërsa sa i përket rasteve disiplinore të raportuara në KGJK, Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjatë periudhës raportuese ka mbajtur pesë seanca dëgjimore në të cilat ka shqyrtuar 11 raporte përfundimtare të pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor duke shqiptuar masa të ndryshme disiplinore, si dhe një rast për gjyqtar, të

dysshuar për kryerje të veprës penale, duke shqiptuar masën me vendim për suspendim të përkohshëm deri në përfundimin e procedurës penale.

Me qëllim ngritjes së mbrojtjes së afërt për gjykatës dhe prokurorë, KPK ka themeluar grupin punues për hartimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për mbrojtje të afërt. KPK pritet që këto PSV t'i miratojë deri në fund të qershorit 2013 për të gjitha objektet e prokurorive.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit me EULEX-in në fushën e sundimit të Ligjit, më 09 nëntor 2012 MD në emër të Qeverisë së Kosovës ka nënshkruar Marrëveshjen Kompakte e cila përcakton objektivat e në fushën e sundimit të ligjit. Për më tepër, MD ka ftuar zyrtaret e EULEX-it për monitorimin gjatë procedurave të seleksionimit dhe të emërimit të zyrtarëve të lartë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, tri procese për seleksionimin e pozitave të drejtorëve dhe gjashtë për zgjedhjen e pozitave të zëvendës-drejtorëve. Ndërsa me ftesë të KPK-së, EULEX-i ka monitoruar valën e dytë të emërimeve të prokurorëve.

Në drejtim të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, në nëntor të vitit 2012 në vijim janë ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare me Shqipërinë: për ekstradim, transferim të personave të dënuar dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet penale, ndërsa përgjatë periudhës raportuese Ministria e Drejtësisë ka pranuar dhe proceduar gjithsej 3992 kërkesa dhe përgjigje, si letër porosi, verifikimi i autenticitetit të dokumenteve, transferimi i procedurës gjyqësore, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja dhe kërkesave të ekstradimit. Për më tepër MD është në përfundim të procesit të funksionalizimit të bazës së të dhënave si dhe janë siguruar dy kasaforta me qëllim të ngritjes së masave të sigurisë së dosjeve konfidenciale dhe sigurimit të të dhënave personale. Ndërsa në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për stafin e Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar janë mbajtur trajnime për çështjet luftimit të terrorizmit, dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar, në bazë të mandatit të saj ka intensifikuar aktivitetet e saj në implementimin e dispozitave të lë shuara nga autoritetet kompetente lidhur me konfiskimin e pasurisë. Gjatë periudhës raportuese AMSK ka realizuar të hyra në shumën prej € 85,451.94.

Me qëllim të avancimit ligjor të gjyqësorit, gjatë periudhës raportuese IGJK ka ofruar trajnime të specializuara për gjyqtare dhe prokurorë për çështjet e krimeve të luftës, Etika gjyqësore dhe profesionale, dhe menaxhimin e rasteve duke i trajnuar gjithsej 20 gjyqtarë dhe 6 prokurorë.

*Tabla e Trajnimeve të mbajtura nga IGJK*

| Topics                           | Gjyqtar | Prokuror | Të tjera | Totali |
|----------------------------------|---------|----------|----------|--------|
| Etika gjyqësore dhe Profesionale | 11      | 1        | 0        | 12     |
| Shkrim Ligjor                    | 25      | 0        | 0        | 25     |
| Menaxhim I Rasteve               | 4       | 5        | 0        | 9      |
| Menaxhimin e Gjykatave           | 20      | 0        | 23       | 43     |
| Aftësi për procedurë gjyqësore   | 29      | 4        | 11       | 44     |
| Deklarim I fajit                 | 14      | 9        | 1        | 24     |
| Totali                           | 103     | 19       | 35       | 157    |

### **1.1.5. Lufta Kundër Korrupsionit**

Me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore në fushën kundër-korrupsionit, Kuvendi i Kosovës më 11 shkurt 2013 ka miratuar ligjin nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale, dhe strategjia dhe plani i veprimit kundër-korrupsionit. Kuvendi po ashtu ka shqyrtuar raportin vjetor të punës për 2012 të Agjencionit Kundër-Korrupsionit. Në nëntor 2012, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar strategjinë për bashkëpunim ndër-institucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Me qëllim të implementimit të ligjeve në luftimin e korrupsionit, AKK ka proceduar 131 raste të dyshuara për konflikt të interesit, ku 90 prej tyre është shmangur konfliktit të interesit, 25 raste janë përfunduar pa konflikt të interesit, 2 raste nën hetim, 2 raste është iniciuar kërkesa për shkarkim/kundërvajtje, në 4 raste është dhënë opinion dhe 8 raste janë barte në vitin vijues. Po ashtu AKK ka iniciuar procedura kundërvajtëse ndaj 308 zyrtarëve të lartë publik, që kanë shpërfillur deklarin e pasurisë, ndërsa lidhur me rastet e deklarin të rremë ka filluar kontroll paraprak për vërtetimin e ekzistimit të konfliktit të interesit. Nga 1 Janari i vitit 2013 sipas kodit të ri penal rastet e konfliktit të interesit, mos deklarin dhe deklarin të rreme të pasurisë do të sanksionohen si vepra penale.

Me qëllim të avancimit profesional për gjyqtarë dhe prokurorë në çështjet e korrupsionit, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur trajnime të specializuara për luftimin e korrupsionit dhe krimin e organizuar me gjithsejtë 83 gjyqtar, prokuror, zyrtar policor dhe zyrtar nga AKK, zyrtarë nga pjesëmarrës (53 gjyqtarë, 29 prokurorë, 9 zyrtarë nga Polica e Kosovës, 10 zyrtarë nga Zyra e Auditorit dhe Komisioni Rregullativ për Prokurimit Publik.

## **1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

### **1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

Me qëllim të adresimit të kriterit në lidhje me përgjegjësinë penale të medieve dhe mbrojtjen e burimeve të gazetareve, gjatë periudhës raportuese ka përfunduar plotësim-ndryshimi i Kodit Penal. Në kuadër të Kodit të plotësuar-ndryshuar Penal të Republikës së Kosovës, të miratuar më 19 Tetor 2012 dhe të dekretuar më 02 nëntor 2012, janë eliminuar nenet 37, 38 dhe 39, lidhur me përgjegjësinë penale të medieve dhe mbrojtjen e burimeve të gazetareve. Sa i përket zbatimit të Ligjit kundër Dhunës në Familje, gjatë periudhës raportuese janë miratuar tri akte nënligjore:

- UA për trajtimin e kryesve të dhunës në familje nën ndikimin e substancave alkoolike-psikotrope;
- UA për trajtimin psiko-social të kryesve të dhunës në familje; dhe
- PSO për procedura të harmonizuara hetimore të institucioneve kundër dhunës në familje.

Sa i përket zbatimit të Ligjit mbi Hoqën e Madhe dhe Ligji mbi Qendrën Historike të Prizrenit, janë zbatuar aktet dhe vendimet në vazhdim:

- UA për themelimin e Bordit për Implementim dhe Monitorim, e miratuar më 12 shkurt 2013;
- Propozimi për themelimin e Këshillit për Hoqën e Madhe, e miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit më 28 shkurt 2013;
- Vendimi mbi themelimin e Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit, i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 21 shkurt 2013.

Në drejtim të ndërtimit të institucioneve, Koordinatori për të Drejta Pronësore është akomoduar në objektin e ZKM-së dhe nga marsi 2013 është rekrutuar një ekspert për këtë fushë. Në fushën e personave të zhdukur, ZKM ka dërguar në Agjencinë Shtetërore të Arkivave kërkesën për tri raste konkrete lidhur me kërkesat e pranuar nga Beogradi.

Për më tepër, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe të keqpërdorimeve të mundshme të personelit, SHKK ka shqyrtuar 12 raste disiplinore, ku kanë qenë të përfshirë zyrtarët e këtij institucioni dhe prej të cilëve katër (4) janë transferuar në vende tjera të punës, katër (4) të tjerë janë larguar nga puna, ndërsa katër (4) të fundit kanë marrë vërejtje me shkrim. Në vazhden e ngritjes profesionale të stafit të shërbimeve korrektuese, SHKK ka hartuar Planin e Trajnimit për 2013 dhe gjatë periudhës raportuese janë mbajtur pesë (5) trajnime për 30 zyrtarë të SHKK-së, me fokus në asistimin adekuat të zyrtarëve ndaj personave me varësi si dhe në ngritjen e kapaciteteve të institucionit.

Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me të drejtat e njeriut, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar trajnime për 28 gjyqtarë dhe 4 prokurorë gjatë periudhës raportuese, lidhur me Konventën Evropiane në të Drejtat e Njeriut.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të performancës në punë të inspektorëve të punës, inspektorati i punës brenda MPMS ka organizuar trajnimet në vijim:

**Tabela 2: Statistikat mbi trajnimet për inspektorët e punës**

| Temat e trajnimeve   | Nr. i inspektorëve të trajnuar |
|--|--------------------------------|
| Siguria dhe shëndeti në punë   | 25                             |
| Parandalimi i formave të rrezikshme dhe të dhunshme të punës së fëmijëve | 17                             |
| Anti-trafikimi me qenie njerëzore  | 14                             |

*Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*

**Tabela 3: Statistikat mbi kontestet lidhur me largimin nga shtëpia/banesa**

| Statusi i lëndëve | Nr. i lëndëve |
|-------------------|---------------|
| Të trashëguara    | 82            |
| Të pranuar        | 29            |
| Të zgjidhura      | 47            |
| Të pazgjidhura    | 64            |

*Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

**Tabela 4: Statistikat e gjykatave në lidhje me dhunën në familje**

| Statusi i lëndëve | Nr. i lëndëve |
|-------------------|---------------|
| Të trashëguara    | 338           |
| Të pranuar        | 258           |
| Të zgjidhura      | 226           |
| Të pazgjidhura    | 370           |

*Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

### 1.2.2. Të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e pakicave

Në fushën e të drejtave, respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve, me 12 shkurt 2013 u miratua UA për themelimin e Këshillit Zbatues dhe Monitorues (KZM). Kësisoj, u themelua KZM, i cili përbëhet nga pesë (5) anëtarë që vijnë nga MMPH, MKRS, BE, OSBE dhe KOS. Në drejtim të funksionalizimit të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët me 19.12.2012 është emëruar Komisioneri për Gjuhët, i cili ka filluar të ushtrojë funksionin e tij në janar të vitit 2013. Po ashtu është siguruar hapësira fizike si dhe është ndarë buxheti i mjaftueshëm për funksionalizimin e kësaj zyre. Për më tepër, është themeluar

kanali televiziv në gjuhën serbe në kuadër të transmetuesit publik (RTK), i cili do të fillojë punën në maj 2013.

**Tabela 5: Buxheti i ndarë nga ministritë për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit, si dhe 40 rekomandimeve për komunitetet RAE**

| Institucioni                                 | Buxheti në Euro (€)                            |
|--|--|
| Ministria e Shëndetësisë                     | 55,000   |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 18,000   |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit     | 87,216   |
| Ministria e Zhvillimit Ekonomik              | 5,000  |
| Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve         | I paspecifikuar (në kuadër të buxhetit vjetor) |

Burimi: Zyra e Kryeministrit

Sa i përket sulmeve fizike të motivuara në baza fetare ose etnie, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2012 ka ngritur aktakuzë ndaj katër (4) personave të dyshuar, përderisa PK ka raportuar për hetimin e 17 rasteve.

**Tabela 6: Statistikat e gjykatave në lidhje me sulmet fizike të motivuara në baza fetare ose etnie për vitin 2012**

| Statusi i lëndëve | Nr. i lëndëve |
|-------------------|---------------|
| Të trashëguara    | 4             |
| Të pranuar        | 0             |
| Të zgjidhura      | 2             |
| Të pazgjidhura    | 2             |

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Në drejtim të përfshirjes së komuniteteve pakicë në Administratën Publike, përqindja e tyre sipas raportit periodik të MAP është 10.29% e të punësuarve. Ndërsa, sa i përket qasjes në arsim dhe zvogëlimit të shkallës së braktisjes së shkollimit nga komunitetet RAE, në vitin akademik 2012/2013, në shkolla fillore dhe të mesme ka: 1,996 romë, 1,196 egjiptianë dhe 4,068 ashkalinj, përderisa janë rikthyer 89 nxënës. MKK gjatë periudhës raportuese ka ndërtuar 52 shtëpi për të kthyerit. Numri i përgjithshëm i të kthyerve gjatë vitit 2012 është 422 persona.

**Tabela 7: Projektet infrastrukturore të realizuara gjatë vitit 2012**

| Projektet  | Kostoja në Euro (€) |
|--|---------------------|
| Ndërtimi i Sheshit në Qendrën e vjetër, KK Shtërpce  | 42,399.73           |
| Ndërtimi i terrenit për futboll me objektin përcjellës në fshatin Firajë, KK Shtërpce          | 70,000.00           |
| Renovimi i dy urave në fshatin Vërbeshticë, KK Shtërpce  | 9,567.90            |
| Vendosja e gypave të ujësjellësit në lagjen Bollovan, KK Shtërpce                              | 9,668.00            |
| Ndërtimi i terrenit të basketbollit, KK Shtërpce   | 9,503.04            |
| Furnizimi me lodra për 4 parqet argëtuese, KK Shtërpce   | 9,798.00            |
| Rregullimi i sheshit dhe vendosja e koshit të basketbollit, KK Shtërpce                        | 9,790.00            |
| Furnizimi me material për rregullimin e ndriçimit në fshatin Opterush dhe Zoqishte, KK Rahovec | 10,000.00           |
| Furnizimi me zhavorr për rregullimin e rrugëve në fshatin Zoqishte, KK Rahovec                 | 10,000.00           |
| Ndërtimi ihallës sportive, KK Shtërpce   | 500,000.00          |

**Tabela 8: Projektet e realizuara në 2012 nga MKK në funksion të kthimit, ri-integrimit dhe stabilizimit të komuniteteve**

| Kategoritë e përkrahjes   | Kostoja në Euro (€) |
|---|---------------------|
| Përkrahja e 18 projekteve të OJQ-ve   | 117,201.00          |
| Furnizimi me material ndërtimor për 121 familje   | 378,000.00          |
| Shpërndarja e pakove ushqimore-higjienike për familjet e kthyer dhe familjeve me kushte të vështira sociale | 9,666.90            |
| Shpërndarja e lëndëve djegëse për familjet e kthyer dhe familjet me kushte të vështira sociale              | 6,993.91            |

Burimi: Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve

Në kuadër të “Projektit për Stabilizimin dhe Ri-integrimin e Komuniteteve,” që ka për qëllim ofrimin e mbështetjes për bizneset individuale Start-ups (zhvillimi i ekonomisë së vogël dhe i biznesit familjar), MKK-ja ka furnizuar 29 përfitues nga Klina, Prizreni, Shtërpce, Istogu dhe Rahoveci me mjete të punës.

### 1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Me qëllim të avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale si dhe politikave relevante për bashkëpunim rajonal, Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në takimin e fundit të Bordit për vitin 2012 (Tetor 2012) ka arritur konsensus mbi draftimin e Statutit të ri të KBR-së, ku do të përfshihej edhe kërkesa formale e Kosovës mbi përfaqësimin efektiv bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes së vendeve në KBR si dhe implementimin e Marrëveshjes së arritur mes Prishtinës dhe Beogradit, të ndërmjetësuar nga BE në Shkurt 2012. Me këtë rast, në takimin e parë të Bordit më 28 shkurt 2013, KBR vendosi të ndryshojë Statutin dhe listën e pjesëmarrësve të organizatës, duke reflektuar rezultatet e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Me 19 prill 2013, me ndërmjetësim të PL/ZP Baroneshës Ashton, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Republika e Serbisë kanë arritur marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve mes këtyre dy shteteve.

## 2. KRITERET EKONOMIKE

### 2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SE TREGUT

Qeveria e Kosovës ka vazhduar me politika të matura edhe përgjatë kësaj periudhe raportuese, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë buxhetore dhe asaj makroekonomike. Gjatë muajit Mars, FMN ka bërë vlerësimin e dytë të kriterëve të përcaktuara për fund të Dhjetorit 2012 me programin SBA. Si rezultat, FMN ka vlerësuar pozitivisht të gjitha kriteret në përjashtim të kriterit për akumulimin e pagesave të vonuara si dhe tejkalimin e kufirit të deficitit primar për 1 milionë euro. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës do të kërkojë përjashtim të këtij kriteri për këtë periudhë gjë që do të ndikojë në vlerësimin pozitiv të programit në përgjithësi. Në përgjithësi, FMN ka dhënë vlerësim pozitiv të performancës ekonomike në Kosovë.

Në përputhje me kriteret e programit SBA, Qeveria e Kosovës në mars 2013 ka përgatitur amendamentet dhe ka dorëzuar në Kuvend ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë për të adoptuar rregullën fiskale të bazuar në ligj. Rregulla fiskale pritet të aplikohet me fillim nga buxheti i vitit 2014 dhe përcakton kufirin e deficitit të përgjithshëm në 2% të BPV-së.

Ne kuader te pergatitjeve per hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016, iu kane dërguar instruksionet të gjitha organizatave buxhetore për hartimin e pjesëve sektoriale të KASH-it duke përfshire politikat dhe objektivat e tyre te matshme dhe të kostueshme, në përputhje me Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë.

### 2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike

Edhe pse në masë të kufizuar, kriza ekonomike në euro-zonë ka transmetuar efektet e saj edhe në Kosovë. Bazuar ne të dhënat preliminare për fundin e vitit 2012, BPV reale vlerësohet të jetë rritur me 2.4%. Rritjes më të ulët ekonomike i kanë kontribuar kryesisht rënia e konsumit në përgjithësi dhe rënia e eksporteve.

Rënia e kërkesës botërore e shoqëruar me rënien e çmimeve ndërkombëtare të metaleve ka ndikuar qe eksporti i mallrave ne Kosove te bie për rreth 11% ne norma nominale. Sidoqoftë, rënien e eksportit te mallrave ne mase te madhe e ka kompensuar rritja e eksportit te shërbimeve te cilat gjate vitit 2012 shënuar një rritje prej 3%. Konsumi në përgjithësi ka shënuar rënie në terma reale pavarësisht rritjes së dërgesave nga diaspora. Bazuar ne strukturën e importit gjate vitit 2012, konsumi privat vlerësohet të jetë rritur me rreth 0.9%, përderisa ne vlerë reale ai ka rënë për rreth 1.5%.

Po ashtu, importi i mallrave ka rënë me 1% ne vitin 2012 krahasuar me vitin e kaluar. Importi i shërbimeve ka rënë për rreth 18% në vitin 2012, pjesërisht i ndikuar edhe nga rënja e importit të mallrave në zvoglimin e importit të shërbimeve. Megjithatë, kontributin me te madh ne rënien e importit te shërbimeve e ka dhënë rënia importit te shërbimeve biznesore, komponentë kjo me pjesëmarrjen më të madhe në total importin e shërbimeve.

Duke pasur parasysh qe kontributi me i madhe në investime vjen nga sektori i ndërtimitarisë, rënia e çmimeve ndërkombëtare e metaleve e shoqëruar me rënien e çmimeve te materialeve tjera ndërtimore ka ndikuar qe investimet të shënojnë rritje pozitive. Gjatë vitit 2012, investimet në përgjithësi kanë shënuar rritje prej 4.5% në norma nominale dhe rreth 8.5% në norma reale. Kontribut të veçantë këtu kanë dhënë edhe investimet publike të cilat gjatë këtij viti kanë shënuar rritje prej 7.2% në norma reale.

**Tabela 9: BPV nominale dhe rritja reale e saj**

| Pershkrimi                         | 2008  | 2009  | 2010  | 2011  | 2012<br>Vler |
|------------------------------------|-------|-------|-------|-------|--------------|
| Ne miliona euro                    |       |       |       |       |              |
| Konsumi                            | 4,345 | 4,301 | 4,557 | 5,023 | 5,085        |
| Investimet                         | 1,094 | 1,164 | 1,342 | 1,531 | 1,596        |
| Eksporti i mallrave dhe shërbimeve | 609   | 657   | 835   | 959   | 939          |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve  | 2,107 | 2,114 | 2,443 | 2,737 | 2,649        |
| BPV nominale                       | 3,940 | 4,008 | 4,291 | 4,776 | 4,972        |
| Rritja reale e BPV-se, ne %        | 7.2%  | 3.5%  | 3.2%  | 4.5%  | 2.9%         |
| ICK, ne %                          | 9.3%  | -2.4% | 3.5%  | 7.4%  | 2.5%         |

*Burimi: ASK dhe vlerësimet e njësisë se Makroekonomisë, MF*

Metodologjia e përdorur për kalkulimin e rritjes reale është ndryshuar në pajtim me metodologjinë e përdorur nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK). Rritjet për vitet 2008-2011 janë kalkuluar nga ASK, duke paraqitur rritjen reale në krahasim me vlerën nominale të vitit paraprak. Me të njëjtën metodologji është bërë edhe vlerësimi i rritjes reale për vitin 2012 dhe vitet vijuese nga ana e

Ministrisë së Financave. Në Prill të vitit 2013, BQK ka publikuar të dhënat për Bilancin e Pagesave të rishikuar për vlerën e eksportit të shërbimeve filluar nga viti 2009. Këto të dhëna për vitin 2012 nuk janë inkorporuar meqenëse pritet që ASK të bëjë rifreskimin e llogarive kombëtare si reflektim të këtyre ndryshimeve që nga viti 2009.

### **Bilanci i pagesave**

Vlerësimet për bilancin e pagesave për vitin 2012 tregojnë për një ngritje të lehtë të deficitit tregtar, përmirësim të llogarisë së shërbimeve, përmirësim të llogarisë së të ardhurave dhe të transfereve dhe si rrjedhojë rënie të theksuar të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Llogaria kapitale dhe financiare shënoi bilanc pozitiv mirëpo dukshëm më të ulët sesa vitet paraqake.

Gjatë vitit 2012, importi i mallrave shënoi një rënie të lehtë prej 1%. Kjo rënie e importeve gjatë kësaj periudhe mund të jetë shkaktuar si rezultat i stabilizimit dhe të çmimeve të produkteve kryesore që importon Kosova siç janë produktet ushqimore dhe produktet minerale, të cilat kryesisht përbëhen nga derivatet e naftës. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të komponentëve kryesorë të cilët i eksporton Kosova si dhe rënia e përgjithshme e kërkesës në nivel rajonal ka ndikuar në rënien e vlerës së eksportit të mallrave i cili gjatë vitit 2012 për 11.7%. Në raport me PBB-në, bilanci tregtar ka arriti në 42.2% krahasuar me 43.1% sa ishte në vitin 2011.

Në anën tjetër, eksporti i shërbimeve ka shënuar një ngritje prej 2.7% gjatë vitit 2012 ndërsa importit i shërbimeve ka shënuar rënie prej 18.1%. Kjo ngritje e eksportit të shërbimeve kryesisht është ndikuar nga ngritja e shërbimeve të udhëtimit si dhe atyre të komunikimit, ndërtimitarisë, dhe shërbimeve të sigurimit. Si rezultat, neto shërbimet në raport me PBB-në u ngritën në 7.1% nga 5.6% sa ishte në vitin 2011.

Për sa i përket llogarisë së të ardhurave, gjatë vitit 2012, të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve kanë shënuar një rënie të lehtë prej 0.6% krahas rënies prej 38.1% të të dalave në formë të profitit të rikthyer nga investimet e huaja direkte si dhe investimeve tjera nga ana e investitorëve të huaj. Si rezultat, llogaria e të hyrave neto ka shënuar një ngritje prej rreth 35.1% duke arritur në 3.1% të PBB-së nga 2.4% sa ishte në vitin 2011.

Edhe llogaria e transfereve ka shënuar një rritje të theksuar (16.8%). Kjo për faktin që transferet jashtë Kosovës kanë shënuar rënie prej 7.4% si rezultat i zvogëlimit në vazhdimësi të prezencës së misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Për më shumë, gjatë vitit 2012, transferet në Kosovë janë ngritur për 14.4%. Dërgesat nga diaspora kanë arritur vlerën prej 605.6 milionë euro duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 3.6%.

Llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, mirëpo dukshëm më të ulët sesa vitet paraqake. Në vitin 2012, bilanci i kësaj llogarie arriti vlerën prej 140.1 milionë euro që paraqet një rënie prej 66.6 përqind krahasuar me vitin paraqak. Kontribuuesi kryesor në kuadër të bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD), pasuar nga investimet tjera, ndërsa ndikim negativ në bilancin e llogarisë financiare vazhdon të ketë rritja e vazhdueshme e investimeve portfolio dhe asetëve rezervë jashtë ekonomisë së Kosovës. Sidoqoftë, ndikimin më të madhe në rënien e kësaj llogarie në vitin 2012 e shënuan investimet direkte, bilanci i të cilat shënoi rënie prej 43.7% si dhe rënia e investimeve tjera, kryesisht depozitave.

### **Trendet në papunësi dhe punësim**

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të dhjetorit 2012 ishte 259,341 duke



shënuar një rënie prej 20.3% krahasuar me numrin e te regjistruarve ne periudhën e njëjtë të vitit 2011. Kategoria e personave te pakualifikuar përbën rreth 57% e te gjithë te papunëve pasuar nga femrat qe përbejnë 31% të të papunëve dhe kategoria me kualifikim te mesëm shkollor me 28%. Ndërsa vetëm ne periudhën janar-dhjetor 2012 sipas zyrave te punësimit janë regjistruar si te papune gjithsej 24,879 persona te rinj. Nga ana tjetër, numri i të punësuarve përmes zyrave të punësimit për vitin 2012 arriti në 90,799 persona.

### **Indekset e trendit të inflacionit (mundësisht HICP) (inflacioni bazë)**

Pas një ngritjeje te theksuar gjate vitit 2011, niveli i çmimeve te konsumit ne Kosove u stabilizua duke shënuar një rritje prej 2.5%. Kjo rritje kryesisht u ndikua nga presionet inflacioniste në gjysmën e dytë të vitit. Për shkak të thatësisë së madhe, çmimet ndërkombëtare te ushqimit te ngritën duke u reflektuar drejtpërdrejt edhe në nivelin e çmimeve në Kosovë. Si rrjedhojë, çmimet e ushqimit kontribuar me 0.3% në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Lëvizja e çmimeve ndërkombëtare të naftës reflektohet drejtpërdrejt në çmimet e naftës në vend. Andaj, gjatë vitit 2012, çmimet e naftës kontribuan me 0.3% në rritjen e indeksit të çmimeve të konsumit (ICK). Ngritjes së çmimeve në Kosovë kontribut të veçantë i kanë dhënë edhe çmimet e shërbimeve komunale sikurse ato të energjisë elektrike dhe ujit të cilat së bashku kontribuan me 0.9% në rritjen e indeksit të çmimeve të konsumit.

Përfunduar çmimet e ushqimit dhe naftës, ICK baze u ngrit me një mesatare prej 3.6% gjë qe e vërteton faktin që kontributin më të madh në rritjen e ICK-së kanë dhënë çmimet e shërbimeve komunale.

### **2.1.2. Raportimi në lidhje me politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese**

#### **Evoluimi i politikave fiskale**

Gjatë periudhës shtator 2012- mars 2013 ndodhën disa ndryshime në politikat fiskale. Së pari, Ligji nr. 04/L-117 mbi Taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve hyri në fuqi më 28 shtator 2012. Pastaj, është aprovuar në Kuvend ndryshimi i Ligjit nr. 03/L- 146 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar me të cilin bëhet zgjatja e periudhës kalimtare prej 1 Janari 2013 deri me 31 dhjetor 2014 për lirim nga pagesa e TVSH-së për importin dhe furnizimin e mallrave qe janë te liruara nga pagesa e TVSH-se. Këtu hyn Aneksi IV i produkteve bujqësore, furnizimi i mallrave apo shërbimeve nga grantet e donatorëve, dhe furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të bëra për Kombet e Bashkuara, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndër qeveritare. Gjithashtu, është përpiluar Projektligji për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, është shqyrtuar nga Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa, është aprovuar nga Kuvendi, por sidoqoftë është kthyer prapa nga Presidentja për rishqyrtim.

Politikat e matura fiskale në vitin 2012 kanë rezultuar që deficitin primar të jetë në kufirin e përcaktuar me programin SBA me FMN. Me saktësisht, edhe pse mbledhja e të hyrave nuk ka qenë në nivel të planit, masat e matura ndaj shpenzimeve kanë ndikuar që bilanci primar të arrijë në 113 milionë euro apo rreth 3% e BPV-së. Si rezultat, edhe bilanci bankar i Qeverisë është mbajtur mbi nivelin e rekomanduar nga FMN në 215.5 milionë euro.

Buxheti i vitit 2013 planifikon shpenzime në vlerë prej 1,578 milionë euro përderisa të hyrat janë planifikuar në shumën prej 1,422 milionë euro. Kufiri i deficitit primar, e që është edhe kriter me programin SBA, është 155 milionë euro përderisa bilanci i përgjithshëm planifikohet të kapë vlerën prej 174 milionë euro.

Sa i përket te hyrave, edhe pse në rënie, pjesëmarrjen më të madhe pritet ta kenë të hyrat nga kufiri të cilat janë planifikuar në shumë prej 915 milionë euro. Të hyrat vendore janë planifikuar të kapin shumën prej 301 milionë euro. Gjatë këtij viti, po ashtu planifikohen edhe të hyra shtesë nga tantiema e ngritur në linjit e po ashtu pritet edhe inkasimi i dividendës në vlerë prej 30 milionë euro. Liberalizimi i tregut të telefonisë mobile pritet të sjellë të hyra shtesë prej 20 milionë euro gjatë vitit 2013.

Deri në fund të Marsit 2013, realizimi i të hyrave ka arritur në 11.8% të planit e që korrespondon me shumën prej 270 milionë euro. Nga të hyrat totale, përveç të hyrave nga kufiri të gjitha kategoritë tjera të të hyrave janë duke performuar sipas planit mujor. Ky trend jep sinjale pozitive që deri në fund të vitit të hyrat do të realizohen sipas planit në tërësi duke mundësuar kështu edhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara me SBA.

Sa i përket ekzekutimit të shpenzimeve për vitin 2013, deri në fund të Marsit shpenzimet rrjedhëse janë ekzekutuar me 13.7% ndaj planit duke arritur vlerën prej 194 milionë euro. Nga 621 milionë euro të buxhetuara për shpenzimet kapitale, 9.8% janë realizuar deri në fund të Marsit 2013. Rrjedhimisht, realizimi i shpenzimeve totale gjatë kësaj periudhe ka arritur raportin prej 11.2% ndaj planit. Gjatë kësaj periudhe janë inkasuar rreth 1.5 milionë euro nga kthimi i kredisë nga KEK-u. Tabela më poshtë paraqet shpenzimet sipas nën-kategorive për qeverinë qendrore dhe qeverinë lokale.

### **Borxhi i përgjithshëm i qeverisë**

Borxhi i përgjithshëm i qeverisë ka pasur trend rritës. Me krijimin e tij në vitin 2009 e deri më tani ka shënuar rritje. Borxhi i përgjithshëm i qeverisë në fund të muajit mars ishte 406.6 milion euro apo 7.86% e BPV-së, duke lënë ende mjaftë hapësirë për huamarrje. Nominalisht, borxhi i jashtëm në tremujorin e parë të 2013 ishte rreth 332 milion euro, ose 82% e borxhit të përgjithshëm. Ndërkaq borxhi i brendshëm (domestic debt) ka arritur vlerën 74 milion euro ose 18% e borxhit total.

### **2.1.3. Ndërveprimi i forcave të tregut**

#### **Madhësia e sektorit privat**

Siç shihet në tabelën më poshtë, sektori privat që nga viti 2009 në vazhdimësi ka rritur pjesëmarrjen në BPV. Konsumi privat ka pjesëmarrjen më të madhe në BPV dhe që nga viti 2009 ka rritur pjesëmarrjen në BPV për 17 pikë të përqindjes. Kjo mund të jetë rezultat i rritjes së pagave të disa kategorive të shërbyesve civil por në masë të madhe kjo i atribuohet rritjes së vazhdueshme të dërgesave nga diaspora si dhe konsumit të tyre gjatë vizitës në Kosovë. Njësoj si konsumi privat, edhe investimet private kanë rritur pjesëmarrjen për 7 pika të përqindjes në krahasim me vitin 2009.

**Tabela 10: Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV**

| Pershkrimi         | 2009 | 2010 | 2011  | 2012  |
|--------------------|------|------|-------|-------|
|                    | Ne % |      |       |       |
| Konsumi Privat     | 90.0 | 95.4 | 105.3 | 107.0 |
| Investimet Private | 19.1 | 22.1 | 25.0  | 26.1  |

### **Privatizimi**

Nga numri i përgjithshëm prej 179 ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë nën procesin e likuidimit, vetëm për 4 NSh kanë përfunduar të gjitha procedurat e likuidimit. Për pjesën tjetër të ndërmarrjeve (173) ende janë duke vazhduar procedurat e likuidimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit në këte

periudhe ka angazhuar konzorciumin “Deloitte dhe Tashko&Pustina” për projektin e ofrimit të Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të riorganizimit të ndërmarrjeve ‘te mëdha’ shoqërore (NSH), Agjencia Kosovare e Privatizimit në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe eksperte gjermane ka themeluar katër grupe punuese (GP) për katër fushat kryesore të riorganizimit:

- Grupi Punues për çështje Ligjore;
- Grupi punues për çështje të Kontabilitetit dhe Financave;
- Grupi Punues për caktimin dhe vlerësimin e rezervave të xehe;
- Grupi punues për çështje mjedisore dhe sociale.

Grupet punuese në periudhën nëntor-dhjetor 2012 kanë hartuar planin e veprimit i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të Riorganizimit. Në kuadër të tyre ka përfunduar regjistrimi i aseteve, si dhe është duke u bërë caktimi dhe vlerësimi i rezervave të xeheve.

### **Hyrja dhe dalja e bizneseve**

Nga 1 shtatori 2012 deri në mesin e prillit 2013 ,janë regjistruar 6562 biznese të reja ose 5.35% e numrit total të bizneseve. Në të njëjtën kohë janë shuar 876 biznese ose 0.71% e totalit. Në kuadër të shërbimeve “one-stop-shop” për regjistrimin e biznesit në mbarë Kosovën, janë hapur edhe tri qendra komunale që e sjell numrin e qendrave me bazë qendrore e të dhënave unike të centralizuara në 28 qendrat komunale.

### **Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative**

Me qëllim të përmirësimit të ambientit biznesor është bërë integrimi i sistemeve të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) me çka është arritur që të kryhen të gjitha shërbimet e nevojshme në një vend: Certifikatën e Regjistrimit, Numrin Fiskal, Certifikatën e TVSH dhe Certifikatën Doganore. Për regjistrimin e bizneseve afati kohor është 1-3 ditë, të gjitha bizneset Individuale dhe ortakëritë e përgjithshme regjistrimi bëhet brenda një dite kurse për korporatat brenda tri ditëve. Regjistrimi i bizneseve të reja është pa pagesë.

Në funksion të forcimit të të drejtave pronësore, Komisioni për kërkesa pronësore, implementim të kthimit të pronës dhe administrim gjatë periudhës raportuese ka shpërndarë 15,485 vendime palëve dhe janë zbatuar 7.977 vendime duke përfshirë të gjitha format e zbatimit si riposedimi, administrimi, mbyllja e lëndës me kërkesën e palës.

#### **2.1.4. Sektori financiar**

Vlera totale e aseteve të sektorit financiar arriti në 3.8 miliard euro (ose 78.2% e BPV) duke përjashtuar asetet e BQK-së. Sistemi bankar vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe të sektorit financiar (74.0% të aseteve). Fondet pensionale menaxhuan me 19.5% të aseteve, ndërsa kompanitë e sigurimit me 3.4% e aseteve .

Struktura e pronësisë së sektorit bankar ka pësuar ndryshim në fund të vitit 2012, ku në treg hyri një bankë e re e huaj. Numri total i bankave u shtua në nëntë (9), dhe rrjedhimisht përqindja e aseteve bankare në menaxhim të huaj u rrit në rreth 94% në fund të tremujorit të parë të vitit 2013. Sektori bankar karakterizohet me një shkallë relativisht të lartë të koncentrimit. Kjo ngase tri bankat më të mëdha në vend menaxhojnë rreth 69% të aseteve bankare. Sidoqoftë, në vitet e fundit, shkalla e koncentrimit ka rënë në vazhdimësi. Shkalla e koncentrimit e shprehur përmes Indeksit të

Herfindahl-Hirschman (HHI) për asete ka rënë në 1,919 pikë në mars të vitit 2013, krahasuar me 1,972 pikë në dhjetor 2012.

Kreditimi mbetet aktiviteti kryesor i sistemit bankar. Vlera e përgjithshme e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës ishte €1.78 miliardë në mars 2013 (€1.71 në mars 2012). Kreditë janë rritur me normë të ngadalësuar prej rreth 3.8% (norma vjetore) krahasuar me 13.48% në mars të vitit 2012. Bankat kanë raportuar rënie të kërkesës kreditore në pjesën e dytë të vitit 2012, ku rënia ka qenë më e theksuar për ndërmarrjet e mëdha.

Struktura e kredive në mars të vitit 2013 u dominua nga kreditë e dhëna ndërmarrjeve, që përbënin rreth 68.2% të gjithëj kredive (69.8% në mars 2012), ndërsa pjesa tjetër kryesisht prej ekonomive familjare me 30.6%. Depozitat kanë arritur vlerën prej 2.27 miliard euro në mars të vitit 2013 (2.09 miliard në mars të vitit 2012). Depozitat e ekonomive familjare përbëjnë burimin kryesor të financimit të bankave, me rreth 74% të totalit të depozitave. Rritja vjetore e depozitave bankare në mars të vitit 2013 ishte 8.7% (8.8% në mars të 2012).

Norma e aseteve totale të likuiditetit ndaj aseteve totale ishte 31.1% në mars 2013 (30.4% në mars të 2012). Norma e kredive ndaj depozitave u zvogëluar në 78.6 në mars 2013 nga 82.2% në mars të vitit 2012, mirëpo shënoi rritje të lehtë krahasuar me dhjetorin e vitit 2012 (77.4% në dhjetor 2012).

Kreditë jo-performuese u rritën në 7.6% në mars të vitit 2013, krahasuar me 6% sa ishin në mars të vitit 2012. Sidoqoftë, mbulesa e kredive jo-performuese me provizione mbetet relativisht e lartë në rreth 115.5% në mars të vitit 2013 (111.6 në dhjetor 2012 dhe 117% në dhjetor 2011). Sistemi bankar në tërësi mbetet mirë i kapitalizuar. Pas një periudhe relativisht të gjatë që treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 17%, në dhjetor të 2012 ajo u zvogëluar në 14.4%, e dhe pse ende mbi nivelin e kërkuar nga BQK. Sidoqoftë, duhet theksuar se një pjesë e madhe e ndryshimit vie si rezultat e ndryshimeve rregullatore pasi që me rregullativën e re bankat duhet të largojnë huadhënien ndaj partnerëve të lidhur nga Shtylla 1 e kapitalit dhe t'a përfshijnë riskun operacional në asetet me risk të ponderuar. Në mars të vitit 2013 treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit në 15.1%.

Dallimi në mes të normës së interesit për depozita dhe kredi ka shënuar rënie të lehtë në mesatare, ku në mars të vitit 2013 dallimi ishte 9.6% krahasuar me 10.48% në mars të vitit 2012. Sistemi bankar ka operuar me profit prej rreth €6.2 milionë në tremujorin e parë të vitit 2013. Sidoqoftë, profiti ka shënuar rënie prej 15.7% në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2012 (rënia vjetore e profitit në dhjetor 2012 ishte 46.7%). Në mars të vitit 2013 sistemi bankar punësonte 3,749 punëtorë krahasuar me 3,826 sa ishin në mars të 2012.

Sa i përket tregut të sigurimeve, në fund të vitit 2012 ishin gjithsej 13 kompani të sigurimeve që operojnë në treg, dhjetë nga të cilat ofrojnë sigurime jo-jetë ndërsa tri ofruan produkte të sigurimit të jetës. Struktura e pronësisë së tregut të sigurimeve dominohet nga shtatë kompani me pronësi të huaj, dy me pronësi të përzier dhe tri me pronësi tërësisht vendore. Pjesëmarrja e sistemit të sigurimeve në sektorin financiar është e ulët me vetëm 3.4% të totalit të aseteve financiare ose rreth 2.7% si përqindje e BPV.

## **2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT**

### **2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik**

#### **Kapitali njerëzor**

Lidhur me trendin e zhvillimit të kapitalit njerëzor në fushën e arsimit, në vitin akademik 2012-2013 numri i përgjithshëm i studentëve në tri universitetet publike dhe kolegjet private ka qenë rreth 100,000. Me qëllim të rritjes së aktiviteteve kërkimore-shkencore, gjatë vitit 2012 janë ndarë 18 grante për projekte shkencore si dhe janë publikuar 20 punime shkencore në fusha të ndryshme shkencore. Përmes projekteve të vogla shkencore sipas programit kombëtar të shkencës janë financuar 9 projekte, të cilat po ndihmojnë në aspektin e infrastrukturës kërkimore në arsimin e lartë. Ndërsa në periudhën tetor 2012-mars 2013 janë mbështetur 32 kandidat të studimeve të doktoraturës jashtë vendit. Në tremujori i parë të këtij viti, Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA) ka akredituar 12 programe të doktoratës në Universitetin e Prishtinës.

Ndërsa, numri i nxënësve në nivelin e mesëm të lartë është 104,208 për vitin shkollor 2012/2013. Sipas tipit të shkollave, 57% janë në shkolla profesionale ndërsa 43% janë në gjimnaze. Raporti nxënës për mësimdhënës për nivelin e mesëm të lartë është 19.2 ndërsa raporti nxënës për paralele është 31.2.

Sa i përket masave për plotësimin e kërkesave të tregut të punës, ka vazhduar pajisja e kabineteve të Qendrave të Aftësisë Profesionale (QAP) me kabinate të punës. QAP në Gjilan është lëshuar në përdorim në nëntor të 2012 bashkë me 10 kabinate të trajnimit. Po ashtu qendra në Ferizaj është pajisur me laboratorë dhe trajnerë që mundësojnë ofrimin e programeve profesionale të trajnimit në profesionet të cilat zhvillohen në QAP (elektroinstalues, latues, saldues, uritem, hidroinstalime, suvatues, zdrukthëtar, administrim biznesi, kontabilitet). Për këto profesione janë rishikuar kurrikulat dhe është dizajnuar përmbajtja e certifikatës, e cila tani përdoret për certifikimin e kandidatëve në profesionet e akredituara. Në Qendrat e Aftësisë Profesionale, në periudhën tetor-dhjetor 2012 janë përfshirë në trajnim 909 kandidat, prej tyre 549 meshkuj, 360 femra, minoritete 42 dhe persona me aftësi të kufizuara 42 kandidat. Gjithashtu, në periudhën janar/shkurt 2013 janë përfshirë në trajnime 1366 punëkërkues, (nga ky numër, si të bartur nga viti i kaluar në trajnime janë 571). Nga numri i përgjithshëm 517 janë femra dhe 849 meshkuj, minoritete 55 dhe persona me aftësi të kufizuara 11.

Përmes sistemit informativ për Menaxhimin e Punësimit dhe punëkërkuesve, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 24879 punëkërkues të rinj, prej tyre 10437 femra, 3324 nga minoritetet dhe 140 persona me aftësi të kufizuara. Në funksion të zbutjes së papunësisë strukturale në Kosovë, shërbimet publike të punësimit përmes projekteve publike, skemave të trajnimeve në qendrat e aftësisë profesionale, projekteve tjera dhe skemave të punësimeve sezonale kanë ndërmjetësuar në punësim në total 7692 punëkërkues, nga të cilët 1024 janë nga minoritetet.

Ka vazhduar modernizimi i shërbimeve publike të punësimit. Për këtë është bërë edhe përmirësimi i softuerit dhe harduerit si dhe instalimi i pasjeve të TI-së nëpër Zyrat e Punësimit, centralizimi dhe krijimi i moduleve shpesh në databazë. Gjithashtu në proces është funksionalizimi i sistemit informativ të menaxhimit të punësimit (SIMP), me të cilin është krijuar databaza e të dhënave për punëkërkues.

## Kapitali fizik

Si investimet private ashtu edhe ato publike nga viti 2009 kanë shënuar trend rritës. Investimet private vlerësohen të jene te dominuar nga ndërtimtaria ndërsa një pjese e konsiderueshme e investimeve publike është e dedikuar për ndërtimin e rrugës 7 dhe fillimin e ndërtimit të rrugës 6. Për vitin 2013, për ndërtimin e autostradës Merdare-Morine janë alokuar rreth 217 milionë euro ndërsa për fillimin e autostradës Prishtine-Hani i Elezit janë ndarë 29 milionë euro. Subvencione për ndërmarrjet publike janë ndare ne vlere prej 31 milionë euro. Nga këto, për KEK janë ndare 11.6 milionë euro ndërsa për Minierat e Trepçës janë ndare rreth 3.1 milionë euro.

**Tabela 11: Investimet private dhe publike**

| Pershkrimi         | 2009            | 2010  | 2011  | 2012  |
|--------------------|-----------------|-------|-------|-------|
|                    | Ne miliona euro |       |       |       |
| Investimet Publike | 400.4           | 455.4 | 528.2 | 550.2 |
| Investimet Private | 766.0           | 886.6 | 1,003 | 1,046 |

*Vërejtje: Te dhënat për vitin 2012 janë vlerësim*

Si investimet private ashtu edhe ato publike nga viti 2009 kanë shënuar trend rritës. Investimet private vlerësohen të jene te dominuar nga ndërtimtaria ndërsa një pjese e konsiderueshme e investimeve publike është e dedikuar për ndërtimin e rrugës 7 dhe fillimin e ndërtimit të rrugës 6. Për vitin 2013, për ndërtimin e autostradës Merdare-Morine janë flokuar rreth 217 milionë euro ndërsa për fillimin e autostradës Prishtine-Hani i Elezit janë ndare 29 milionë euro.

**Tabela 12: Investimet e Huaja Direkte (IHD) si % e BPV dhe stoku i tyre nga 2004**

| Pershkrimi                   | 2009    | 2010    | 2011  | 2012  |
|------------------------------|---------|---------|-------|-------|
| IHD si % ne BPV              | 7.0     | 7.7     | 7.9   | 4.4   |
| Stoku i IHD, ne miliona euro | 1,493.2 | 1,824.3 | 2,203 | 2,419 |

Gjate vitit 2012, ka pasur një rënie të theksuar të IHD-ve. Deri më tani IHD-të kryesisht ishin të ndërlidhura me procesin e privatizimit. Me ngadalësimin e procesit të privatizimit dhe me ngushtimin e ofertave për kompanitë e mbetura shoqërore edhe të hyrat nga IHD-të kanë rënë. Për më shumë, në rënien e tyre ndikim të rëndësishëm ka pasur edhe kriza në euro-zonë.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, në fund të vitit 2012 ka përfunduar në tërësi ndërtimi i 59 km të autostradës Morinë-Merdare, dy projekte të rrugëve regjionale ne gjatësi 8.4 km dhe një rruge lokale në gjatësi 3.1 km. Njëkohësisht, segmenti M9 Sllatinë - Gjurgjicë është realizuar në masën 96%, ndërsa segmenti M2 Shkabaj - Milloshevë është realizuar në masën 95%.

## 2.2.2. Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

### Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit

Lidhur me zhvillimet në fushën e telekomunikacionit, në tetor të vitit 2012 është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike. Ky Ligj zëvendëson Ligjin për Telekomunikacionin (Nr.2002/7), që është paraqitur si nevojë për mbulimin dhe përcjelljen e zhvillimeve teknologjike dhe të shërbimeve përcjellëse në fushën e komunikimeve elektronike. Ligji është harmonizuar me Kornizën Rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2009. ndër të tjera, ky ligj parashikon edhe kalimin nga regjimi i licencave në

regjimin e autorizimeve të përgjithshme (ang. General Authorization) për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo nënkupton rritje të mundësive dhe përmirësim cilësor të ambientit për investime të reja dhe konkurrencë të drejtë.

Po ashtu, në mars të 2013 është miratuar dokumenti strategjik i "Politikave të Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovë 2013-2020". Në funksion të liberalizimit të tregut, është miratuar nga Qeveria (date 24.08.2012) Vendimi Nr. 04/88 për liberalizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve telekomunikuese mobile për të mundësuar shfrytëzimin e resurseve frekuencore në dispozicion nga operatorët ekzistues të licencuar për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të gjeneratave të ardhshme të shërbimeve telekomunikuese mobile brezëgjera.

Në lidhje me trendin e indikatorëve kryesor të tregut të telekomunikimit, numri i përdoruesve të telefonisë fikse është zvogëluar nga 85,030 në tremujorin e tretë të 2011, në 84,424 përdorues në fund të tremujorit të tretë të 2012 (ose në përqindje, -1.61%). Në të njëjtën kohë, norma e penetrimit të telefonisë fikse për banorë ishte 4.85%. Numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të tremujorit të tretë të 2012 ka arritur në 1,668,895, që shënon një rritje prej 9.76% (ose 148,453 përdorues) krahasuar me TM3-2011. Penetrimi i telefonisë mobile ka arritur në 95.92% në fund të tremujorit të tretë të 2012. Numri i linjave të internetit me qasje brezëgjere i raportuar nga operatorët ka arritur në 142,573 në fund të tremujorit të tretë të 2012. Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të raportuara nga operatorët, penetrimi për familje me qasje brezëgjere në Internet është 47.99%, ndërsa penetrimi i internetit për 100 banorë rezulton të jetë 8.19% në tremujorin e tretë të 2012.

Në kuadër të zhvillimit të kornizës rregulluese të energjisë, është nxjerr Udhëzimi Administrativ nr. 01/2013 për caqet e burimeve të ripërtërishme të energjisë, Udhëzimi administrativ Nr. 14/2012 për promovimin e efikasitetit të energjisë të përdoruesit fundor dhe shërbimet energjetike, dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për etiketimin e pajisjeve që shfrytëzojnë energji.

## **Struktura sektoriale**

### **Ndërmarrjet e vogla**

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë mbi 99% të numrit total të ndërmarrjeve në Kosovë (ARBK, 2012). Klasifikimi sipas madhësisë tregon se 98.39% janë mikro ndërmarrje, ndërmarrje të vogla janë 1.36%, ndërmarrje të mesme janë 0.20% dhe Ndërmarrje të mëdha janë 0.05%. Sipas numrit të punësuarve në sektorin privat, mikro-ndërmarrje (1-9 punëtorë), kanë punësuar 65.2%. Në ndërmarrje të vogla (10-49 punëtorë) janë të punësuar 8.72 %, në ndërmarrje të mesme (50-249 punëtorë) janë të punësuar 7.74 %. (ARBK, 2012).

Për nga forma e pronësisë, NVM-të që kanë formën e regjistrimit si biznes individual përbëjnë rreth 88.72%, ortakëritë 2.91%, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar 7.39%, shoqëritë aksionare 0.33%, kompanitë e huaja 0.50%, NSH-të 0.02%, ndërmarrjet publike 0.01%, kooperativat bujqësore 0.06%, dhe ndërmarrjet nën juridiksionin e AKP-së me 0.03% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve.

## **2.2.3. Ndikimi i shtetit në konkurrencë/konkurueshmëri**

### **Ndërmarrjet e mëdha shtetërore**

Në sektorin e energjisë, është në fazën e përmbylljes projekti i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë elektrike (KEDS). Pagesa e çmimit të blerjes së KKDFE (26.3 milion Euro) që blerësi konzorciumi Calik-Limak duhet ta kryejë ndaj Buxhetit të Kosovës është faza e fundit e përmbylljes financiare. Data e përmbylljes (Long Stop date) është data 3 maj 2013. Po ashtu, është nxjerr vendimi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për themelimin e tre grupeve punuese që do të merren me hartimin e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A, me vlerësimin e ndikimit social si

dhe vlerësimin financiar. Në kuadër të konferencës së donatorëve që pritet të mbahet me 14 Maj 2013 do të trajtohen modalitetet e financimit të këtij procesi.

Në fushën e telekomunikacionit, ka përfunduar procesi i privatizimit të telekomit (telefonisë fikse dhe mobile). Shpallja e ofertuesit të preferuar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK (pa postën) është bërë në muajin prill 2013 me vendim të qeverisë.

### **Ndihma shtetërore**

Në bazë të Ligjit për Ndihmën Shtetërore, me vendimin no. 11/93 të datës 04.10.2012, qeveria ka themeluar Komisionin për Ndihmë Shtetërore, i cili është organ i pavarur vendimmarrës. Zyra për ndihmën shtetërore në kuadër të Autoritetit të Konkurrencës që do të jetë autoriteti monitorues është duke u themeluar. Andaj, aktualisht si mekanizëm monitorues për ndihmën shtetërore për Ndërmarrjet Publike shfrytëzohen Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit të nënshkruara mes NP dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sipas të cilave është e rregulluar mënyra e shfrytëzimit të ndihmave shtetërore, raportimit tremujor për këtë shfrytëzim dhe mënyra e auditivit të këtyre mjeteve.

Gjatë vitit 2012 është dhënë ndihmë shtetërore për implementim të projekteve kapitale dhe mbulim të kostove për shërbime me kualitative për qytetaret për import të energjisë, blerje mazuti për ngrohje, qarkullim të trenit të lire dhe sigurim uji. Vlera e ndihmës së dhënë në 2012 është 31 milion euro (ose rreth 0.6-0.7% e BPV) dhe iu është dhënë 20 ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale. Ndërsa në vitin 2013 ndihmat shtetërore për NP do të jenë në vlerën prej 29 milion euro.

Ndihmat shtetërore në formë të subvencioneve dhe granteve për projekte kapitale shpërndahen për sektorët e energjisë, hekurudhave, ngrohjes qendrore, ujit dhe mbeturinave.

### **2.2.4. Integrimi tregtar**

Gjatë periudhës Shtator 2012- Shkurt 2013, shkëmbimi tregtar me BE-në ishte rreth 518.4 milion euro, nga kjo vlera e importit është 469.9 milion euro ose 39 % e gjithë importit. Për këtë periudhë, eksporti me BE kishte arritur në 48.4 milion euro ose 35 % e totalit të eksporteve. Mallrat janë eksportuar kryesisht në Itali dhe Gjermani, kurse mallrat e importuara vijnë kryesisht nga Gjermania, Italia, Greqia dhe Sllovenia.

Produktet më të eksportuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë Ferro-lidhjet/ Fero nikeli, mbetjet dhe kthimet e bakrit, lëkurat e papërpunuara të gjedheve, turbinat e avullit të ujit dhe turbinat e avujve të tjerë, xeherore dhe koncentre zinku etj. Ndërsa mallrat më të importuara nga BE janë: Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, mjete transporti, produktet e duhanit, dhe medikamentet.

## **3. STANDARDET EVROPIANE**

### **3.1. Tregu i Brendshëm**

#### **3.1.1 Lëvizja e Lirë e Mallrave**

Sistemi rregullativ për zbatimin e rregulloreve teknike përfshinë miratimin e Rregullores teknike për kërkesat teknike për panelet e drurit, Nr.01/2013, më datë 25.01.2013 dhe Rregullores për Informim në lidhje me produktet që janë të rrezikshme, nr. 13/2012, e miratuar më datë 06.12.2012.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka përfunduar reorganizimin e brendshëm në funksion të zhvillimit të metutjeshëm institucional. Struktura e re organizative është e dizajnuar në bazë të praktikave më të mira të BE-së dhe shembujve të marrë në vendet tjera. Departamenti i tregtisë tani



ka tri divizione: Divizioni për marrëveshje tregtare, Divizioni për masat mbrojtëse në tregti dhe, Divizioni për politika tregtare. Ndryshimet tjera me strukturën e re përfshijnë: bashkimin e Agjencisë për Promovimin e Investimeve me Agjencinë për NVM-të; themelimin e dy njësive të reja, një për mallrat strategjike dhe një për nivelin e rezervave të obligueshme të naftës; zyra për pronësinë industriale dhe departamenti i metrologjisë janë transformuar në agjenci; Departamenti i Buxhetit dhe Financave është shndërruar në divizion nën departamentin e financave dhe shërbimeve të përgjithshme; si dhe është themeluar Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit si njësi e veçantë.

Këshilli Ndër-ministror për Politika Tregtare ka themeluar Grupin Punues për Politika Tregtare (GPPT). Në kuadër të këtij grupi, pesë nën-grupet e veçanta kanë mbajtur disa takime, si në vijim: nën-grupi për bujqësi 4 takime, nën-grupi për lehtësimin e tregtisë 4 takime, nën-grupi për shërbime 3 takime, nën-grupi për industri 2 takime dhe nën-grupi për marrëveshje tregtare 1 takim. Bashkë me përgatitjen e Studimit për Vlerësimin e Ndikimit të aspekteve tregtare të MSA-së në ekonominë e Kosovës, është zhvilluar edhe një databazë e shërbimeve bazuar në Listën 120 dhe klasifikimin e OBT-së sipas katër modave. Databaza do të plotësohet me produkte shpesh në vazhdimësi.

Po ashtu, ka përfunduar ristrukturimin i brendshëm i MTT-së e cila përfshinë rritjen e kapaciteteve për analiza ekonomike, me ç'rast janë rekrutuar zyrtarët në pozitat përkatëse sipas strukturës organizative të brendshme.

Nën-grupet për politika tregtare kanë qenë të përfshira në mbledhjen e të dhënave për barrierat tarifore dhe pyetësorëve në kuadër të aktiviteteve konitoruese të implementimit të marrëveshjes CEFTA. Po ashtu, në prill është mbajtur takimi i parë i Grupit Punues për Menaxhimin e Riskut në Dogana. Në tërësi këto janë takimet e mbajtura të nën-komiteteve dhe grupeve punuese në kuadër të CEFTA në tremujorin e parë të 2013: nga një takim i nën-komitetit për barrierat tregtare, nën-grupit për shërbime, komitetit drejtues të CEFTA, takimi strategjik, dhe takimi i nën-komitetit për bujqësi, sanitari dhe fitosanitari.

### **Standardizim**

Në periudhën raportuese janë aprovuar gjithsej 352 Standarde. Këto standarde ndahen në sektorët siç vijon: 123 standarde për transport dhe shërbime postare, 19 standarde për pajisjet mbrojtëse personale, 103 standarde për derivate të naftës dhe gazit, si dhe 107 standarde për makineri. Të gjitha standardet në fuqi janë promovuar përmes publikimit të katalogut të standardeve në format të shtypur dhe elektronik.

### **Akreditim dhe Vlerësimi i Konformitetit**

Në dhjetor të vitit të kaluar është aprovuar U.A. nr. 19/2012 për caktimin e Përmbytjes dhe Përdorimit të Emblemës së Akreditimit.

Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe raportuese janë kryer tri para-vlerësime, shtatë vlerësime dhe janë bërë akreditimet përkatëse, si dhe janë realizuar dymbëdhjetë mbikqyrje. Janë kryer katër vlerësime për Autorizim nga MTT-ja, nga to dy Laborator Testues dhe dy Trupa Inspektues. Po ashtu, është zgjeruar fusha e akreditimit të Laboratorit për Kontrollin e Cilësisë së Produkteve Farmaceutike. Stafit i DAK-ut është trajnuar nga Instituti Gjerman i Metrologjisë (PBT), në gjithsej gjashtë trajnime. Pastaj, katër trajnime janë realizuar për 63 përfaqësues të Trupave Vlerësues të Konformitetit (TVK). Dy trajnime janë bërë për Standardin SK ISO/IEC 17025 dhe dy në Standardin SK ISO/IEC 17020. Poashtu, është bërë rishikimi i dokumentacionit sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17011. Në këtë periudhë, DAK-u ka zgjedhur të gjitha jokonformitetet e gjetura nga vlerësues të Asociacionit Evropian të Akreditimit.

Zhviullimet tjera në fushën e Akreditimit dhe Vlerësimi i Konformitetit përfshijnë kompletimin e laboratorit për madhësi elektrike me sistemin matës për testimin e njehsorëve elektrik dhe komparatorin me klasë të lartë të saktësisë 0.01 për kalibrimin e sistemit matës dhe etaloneve referent. Në kuadër të këtij projekti është çertifikuar stafi për testim dhe kalibrim të njehsorëve elektrik, etaloneve referent-punues dhe instrumenteve multifunksionale. Është çertifikuar stafi për testimin dhe verifikimin e njehsorëve elektronik dhe induktiv, si dhe është trajnuar stafi për Termometri, Madhësi Elektrike, Vëllim, Rrjedhje dhe Forcë.

### **Metrologjia**

Me qëllim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacioni bazë me atë të BE-së, është ndryshuar Ligji për Metrologji, i cili më datë 19.09.2012 është dekretuar nga presidentja. Legjislacioni sekondar për Metrologjinë është plotësuar më tej, në Nëntor 2012 është miratuar U.A. Nr. 17/2012, për kushtet metrologjike për gramarët me masë nominale 1 mg deri 50 kg, si dhe është miratuar U.A. Nr. 16/2012, për kushtet metrologjike për gramarët etalon me masë nominale 50 kg deri 5000 kg;

Funksionalizimi i Laboratorit Qendror të Metrologjisë së Kosovës (LQMK), është arritur me kompletimin e laboratorit për madhësi elektrike me sistemin matës për testimin e njehsorëve elektrik dhe komparatorin me klasë të lartë të saktësisë 0.01, për kalibrimin e sistemit matës dhe etaloneve referent. Për herë të parë janë kalibruar etalonët e Metrologjisë konform kërkesave për akreditim, siç janë: etaloni referent i laboratorit të matjeve elektrike dhe etaloni referent i laboratorit të termometrisë është kalibruar më datë 07.09.2012 në Institutin për Kualitet të Sllovenisë "SIQ", ndërsa Etaloni primar për masë (gramarët e klasës E2) janë kalibruar në muajin Mars 2012 në TUBITAK-UME të Turqisë. Për zhvillimin e mëtejshëm të laboratorëve të metrologjisë në përpunje me standardet ndërkombëtare, zinxhiri i gjurmueshmërisë së etalonave është kryer për etalonat e laboratorit të matjeve elektrike, laboratorin e termometrisë, laboratorin e rrjedhjes, ndërsa në laboratorin e masës do të përfundojë gjatë muajit Maj 2013. Numri i zyrtarëve të çertifikuar është gjithsej gjashtë, ndërsa numri i pergjithshëm i stafit është trembëdhjetë.

### **Mbikëqyrja e tregut**

Sa i përket zhvillimeve legislative, në shkurt të 2013 është aprovuar Ligji nr. 04/L-078 i amendamentuar për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve. Po ashtu, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në prill të 2013. Rregullorja për organizimin e brendshëm të inspektoratit të tregut është nxjerrë bazuar në këtë ligj dhe aprovuar nga qeveria në fund të prillit të këtij viti.

Implementimi i rregulloreve teknike të konformitetit të BE-së, në qerekun e parë të vitit 2013, përfshinë: Rregulloren nr. 03/ 2012 për sigurinë e lodrave, Rregulloren nr. 02/ 2012 për pajisjet elektrike të destinuara për përdorim Brenda kufijve të caktuar të tensionit, Rregulloren nr. 01/2013 për kërkesat teknike për pllakat e drurit, Rregulloren nr.13/2012 për njoftim në lidhje me produktet të cilat janë të rrezikshme për konsumatorët, Rregulloren nr. 11/ 2012 për përmbajtjen e lëndës së parë dhe emërtimet e tekstilit, Rregulloren nr.10/ 2012 për etiketimin e materialeve të pjesëve kryesore të mbathjeve të dedikuara për shitje të konsumatorëve, Rregulloren Nr. 08/ 2012 për pajisjet personale mbrojtëse, Rregulloren nr. 06/2012 për pajisjet me gaz, Rregulloren nr.05/2012 për teleferikët për bartjen e njerëzve, si dhe Rregulloren nr.04/2012 për produktet nga qelqi i kristaltë.

Në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve, në periudhën raportuese janë mbajtur këto trajnime:

- Dy trajnime me inspektorët e tregut dhe oficerët doganorë për zbatimin e Rregullores për Sigurinë e Lodrave, si dhe për Rregullorem për Pajisjet Elektrike me tension të ulët;
- Një trajnim për zbatimin e rregullores për pajisjet elektrike me tension të ulët, ku kanë marr pjesë afro 40 pjesëmarrës, përfshirë operatorët ekonomik të cilët merren me; prodhimin, importin dhe shitjen e pajisjeve elektrike;
- Një trajnim për zbatimin e rregullores për sigurinë e lodrave, ku kanë marrë pjesë afro 30 pjesëmarrës, përfshire operatorët ekonomik të cilët merren me prodhimin, importin dhe shitjen e lodrave.

### **Mbrojtja e konsumatorit**

Ligji i ri për Mbrojtjen e Konsumatorit është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 7 Nëntor, 2012. Ligji i ri është i bazuar në legjislacionin e BE-së dhe mbulon fushat më parë jo të adresuara si: etiketimi i mallit, shitja me aksion, zbritja e çmimeve, pagesa me paradhënie, kontratat derë më derë, shërbimet financiare (kontratat për kredi konsumuese, norma e interesit), kontratat e mbitërheqjeve dhe për kartelat e kreditit, kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit, praktikave të padrejta tregtare, praktikave tregtare mashtruese, praktikat tregtare agresive, reklama krahasuese dhe mashtruese si dhe shitblerja nëpërmjet internetit.

Sa i përket kampanjave vetëdijësuese vlen të ceket që në tre mujorin e fundit të vitit 2012, departamenti për mbrojtje të konsumatorit ka bërë dërgimin e mesazheve telefonike përmes operatorit VALA te të gjithë klientët e saj. Afërsisht 800.000 konsumator janë informuar rreth numrit pa pagesë ku ata mund të bëjnë thirrje në rast se hasin në ndonjë parregullsi. Në këtë kontekst, më 14.03.2013 është mbajtur tryeza për promovim të ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit si dhe janë shpërndarë fletëpalosje dhe notesa për vetëdijësim të konsumatorit.

Kur kemi të bëjmë me ankesat e drejtuara në Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorit, është e rëndësishme të potencohet që nga Shtatori 2012 deri në Prill 2013, janë pranuar gjithsej 125 ankesa, 76 prej tyre tashmë janë shqyrtuar.

### **3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit**

Sa i përket zhvillimeve legjislative, në dhjetor të 2012 është aprovuar Ligji 2012/04-L-133 i ndryshuar dhe i plotësuar për themelimin e sistemit të sigurimit të depozitave për institucionet financiare.

Po ashtu, me qëllim të avancimit të sistemit të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit financiar dhe të pagesave në pajtim me kërkesat dhe standardet Bazël, dhe me qëllim të implementimit të Ligjit Nr. 04/L- 093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare ( I cili ka hyrë në fuqi me 12 Prill 2012), në nëntor të vitit 2012 janë miratuar 9 rregullore të reja dhe janë amandamentuar 12 rregullore për sistemin bankar:

- Rregullore për menaxhimin e rrezikut kreditor;
- Rregullorja për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave;
- Rregullorja për ndryshimet në llogarite të kapitalit të Bankave;
- Rregullorja për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja;
- Rregullorja për depozitën ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja;
- Rregullorja për ekspozimet e mëdha;
- Rregullorja për kufizimet në mbajtjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme;
- Rregullorja për transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën dhe punëtorët e bankës;
- Rregullorja për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja;

- Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
- Rregullorja mbi menaxhimin e riskut operacional;
- Rregullorja mbi mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare;
- Rregullorja për bashkimet dhe përvetësimet bankare;
- Rregullorja për raportimin e bankave në BQK;
- Rregullorja për publikimin e informacionit nga bankat;
- Rregullorja për auditimin e jashtëm të bankave;
- Rregullorja për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm;
- Rregullorja për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje,
- Rregullorja për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave
- Rregullore për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës
- Rregullore për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të bankave

Ndërsa në fushën e sigurimeve në dhjetor 2012 është miratuar Rregullorja mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia

### **3.1.3. Doganat dhe Tatimet**

#### **a. Doganat**

Doganat kanë shënuar progres në zëvendësimin e plotë të sistemit TIMS me sistemin e ri elektronik ASYCUDA Ëorld, ndërsa sistemi ASYCUDA Ëorld është instaluar dhe implementuar në tërësi.

Gjatë periudhës së negociatave Kosovë - Serbi janë themeluar Grupet teknike ku këto grupe kanë zhvilluar takime të rregullta (mes autoriteteve kufitare të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë). Gjatë kësaj periudhe kohore po ashtu është bërë funksionalizimi i gjashtë Pikave Kufitare të Kosovës, të përbashkëta në kufirin me Serbinë sipas MM dhe Protokollit teknik. Gati në tërësi është kompletuar infrastruktura teknike dhe fizike në këto PKK, përveç se nuk është bërë implementimi i plotë i zhdoganimeve të mallrave në PKK Jarinje dhe Bërnjak. Fillimisht janë vendosur kontejnerët dhe është krijuar infrastrukturë e përkohshme në Pikë Kalimet Kufitare (PKK) me Serbinë (3 PKK nga pala Kosovare).

Gjatë periudhës raportuese janë përmirësuar dy objekte: PKK Vërmicë dhe PKK Merdarë, ndërsa ka përfunduar ndërtimi/rrethimi i garazhit për kontroll të detajuar në PKK Vërmicë. Të gjeturat e Blueprint-it janë adresuar dhe në vazhdimësi po punohet për plotësimin e tyre.

Në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe ndihmën reciproke në çështje doganore gjatë periudhës raportuese është nënshkruar marrëveshja në mes të qeverisë së Kosovës dhe qeverisë së Austrisë, Kosovës dhe Hungarisë, dhe marrëveshja mes Doganës së Kosovës dhe Polonisë.

Sa i përket Luftimit të Ekonomisë joformale është shtuar prezenca e njësiteve Anti Kontrabandë (24/7) e veçanërisht në regjionin e Mitrovicës. Numri i operacioneve të zhvilluara në tërë territorin e vendit është 192, ndërsa vetëm në regjionin e Mitrovicës janë realizuar 10 operacione. Numri i rasteve të zbuluar gjatë kësaj periudhe është 101 raste, ndërsa 43 prej tyre vetëm në regjionin e Mitrovicës. Janë ndërmarrë 24 inspektime, 5 raste janë referuar në prokurori ndërsa 6 raste të raportuara në procedura disiplinore, dhe 1 rast në Inspektoratin e Policisë.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur 241 trajnime për ngritjen e mëtutjeshme të efektivitetit të Doganës përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore. Trajnimet janë mbajtur në fusha dhe tema të

ndryshme. Temat e trajnimit që kanë marrë pjesë një numër i konsideruar i zyrtarëve janë: Pastrimi i Parasë i Bazuar në Tregti, Operacionet Sekrete, Prezantimi Kundër Pastrimit të Parasë, Konfiskimi i Aseteve, Parandalimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë, X-Ray- EXBS (The Export Control and Related Border Security), Rreziku i Integritetit Planifikimi dhe Menaxhimi, COGNOS, Masat Doganore për Mbrojtjen e DPI, Tarifa moduli I dhe II, etj.

## **b. Tatimet**

Sa i perket procesit të fiskalizimit numri i përgjithshëm i subjekteve të pajisura me arka fiskale për periudhën raportuese është 1279 me gjithsej 1,527 pajisje elektronike fiskale të instaluara. Në Nëntor 2012 ka filluar fiskalizimi i pikave të shitjes së derivateve të naftës.

Me qëllim të ngritjes së përmbushjes vullnetare dhe luftimit të evazionit fiskal gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar këto aktivitete: janë organizuar 5,536 vizita përmbushëse me qëllim të verifikimit të besueshmërisë së dokumentacionit, 1,142 vizita përmbushëse - kontakte në zyre, 631 vizita përmbushëse edukative, 121 vizita me qëllim parandalimin e dështimit të përmbushjes së obligimeve tatimore, 391 vizita vëzhguese dhe 97 konsultime (takime) me Polici, Prokurorë dhe Dogana.

Nga numri i përgjithshëm i kontrolleve të kryera gjatë periudhës raportuese, 65 nga to janë kontrolle të cilat janë bazuar në analizën e riskut. Ndërsa kontrollet e rastësishme gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 304 raste. Veç kësaj janë realizuar 28,697 vizita në funksion të mbledhjes së borxheve dhe zbatimit të procedurave të mbledhjes së detyrueshme ku si rezultat kemi qarkullim shtesë në vlerë prej 63.8 milion euro.

Sa i perket sistemit të shërbimeve online me qëllim të krijimit të lehtësirave në deklaram, ATK ofron këto shërbime:

- Deklarimi dhe pagesa elektronike e tatimeve - EDI;
- Shkarkimi i deklaratave;
- Blerjet mbi 500 Euro;
- Qendra e regjistrimit të bizneseve "One Stop Shop" e cila ka reduktuar procedurat e regjistrimit të biznesit ku tani biznesi mund të regjistrohet në një vend dhe mund të pajiset me numër fiskal brenda ditës.

Deri më tani janë 25, 957 tatimpagues të cilët kanë deklaruar përmes EDI-it. Tatimet të cilat deklarohen në formë elektronike janë: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Kontributet Pensionale dhe Tatimi i Mbajtur në Burim( Tatimi në të Ardhura Personale). ATK ka sistemin e ndërlidhur me sistemet informative të institucioneve tjera qeveritare si me Doganën, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Administratës Publike, me TRUST-in, me Bankën Qendrore, me Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale.

ATK ka realizuar seminare me tatimpagues në të gjitha regjionet, në mënyrë që t'i njoftoj tatimpaguesit më për së afërmi me deklaramin vjetor dhe të rejat tjera. Përveç aktiviteteve të shumta, ka përgatitur dhe dizajnuar Formularët si në vijim:

- Çertifikatë Rezidence, e cila është në dispozicion të Zyrës së Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve;
- Çertifikata e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga;
- Çertifikata e Mbajtjes në Burim të Tatimit mbi Interesin, të drejtat Pronësore, Qiratë dhe Jo Rezidentët

ATK gjate periudhës raportuese ka realizuar dhe ofruar mbështetje teknike për trajnimin e stafit kryesisht në këto fusha: në fushën e legjislacionit, IT-së dhe në Ruajtjen e Integritetit të të dhënave. Përpos trajnimeve të mbajtura nga vet ATK-ja, gjithashtu edhe organizata GIZ ka ofruar mbështetje teknike për trajnimin e stafit në trajnimin me temë : Metodatat Indirekte. Nga ATK dhe organizatat ndërkombëtare janë mbajtur gjithsej 44 trajnime ku kanë marr pjesë 399 zyrtarë.

### 3.1.4. Konkurrenca

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore, Nenit 17, Ministria e Financave ka aprovuar Rregulloren 01/2012 mbi Procedurat dhe Format e Njoftimit mbi Ndhimën Shtetërore", e cila hyri në fuqi më 08.10.2012. Kjo Rregullore përcakton procedurat për njoftimin e ndihmës shtetërore, procedurat në rast të ndihmës së paligjshme, procedurat për skemat ekzistuese dhe procedurat për raportim dhe monitorim. Kjo rregullore përcakton gjithashtu, format e njoftimit të ndihmës shtetërore dhe format e raportimit vjetor.

Në bazë të Ligjit për Ndhimë Shtetërore Nr. 04/L-024, Nenit 8, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 11/93 të datës 04.10.2012 i ka emëruar anëtarët e Komisionit për Ndhimën Shtetërore, dhe ka përcaktuar mandatin e tyre.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë kësaj periudhe raportuese ka ndërmarr këto vendime:

- Vendimi për shfuqizimin e marrëveshjes për fiksimin e çmimit të biletave ndërmjet agjencive të transportit rrugor në rajonin e Pejës;
- Konkluzioni për monitorimin e industrisë së sigurimeve rreth caktimit dhe ndarjes së tregut në auto përgjegjësinë ndaj palës së tretë;
- Vendimi për shfuqizimin e marrëveshjes dhe praktikës së bashkërenduar për caktimin dhe ngritjen e çmimit të bukës dhe miellit në rajonin e Prishtinës.

Kur kemi të bëjmë me abuzimin me pozitë dominuese, AKK gjatë periudhës raportuese ka realizuar këto aktivitete:

- Monitorimi i tarifave të energjisë elektrike në Kosovë, rajon, dhe bashkëpunimi me Entin Rregullativ për Energji;
- Rekomandim për MTI-në për rishikimin e vendimit Nr. 01/4508 i datës 11.06.2012 për mbrojtjen e prodhimit vendorë të çimentos në Kosovë;
- Rekomandim dedikuar Drejtorisë së Akreditimit të MTI-së, në lidhje me autorizimin e më shumë trupave inspektues dhe laboratorëve për kontrollin e kualitetit të derivateve të naftës.

Në kuadër të aktiviteteve të AKK-së vlen të cekën edhe këto opinione dhënë institucioneve relevante:

- Opinioni dhënë Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me draft-ligjin për ndalimin e ekspozimit të duhanit në vendet publike;
- Dhënia e mendimit profesional ndaj kërkesës së "Kalo & Associates" lidhur me ndalimin e ekspozimit të produkteve të duhanit në Republikën e Kosovës;
- Opinion lidhur me draft-ligjin e transportit publik lidhur me tarifatat e transportit publik;
- Opinion lidhur me përqendrimet dhe mënyrën e realizimit të tyre me Odën Ekonomike Amerikane dhe institucionet e tjera.

### **3.1.5. Prokurimi Publik**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke u bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 më 19.12.2012, për dorëzimin e planifikimeve për prokurim dhe informatave plotësuese. Më tej, KRPP duke u bazuar në Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 më 26.12.2012, për qartësimin e bazës ligjore për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas nenit 32, paragrafit 4, nenit 35 dhe 61 të Ligjit për Prokurim Publik.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, KRPP ka punësuar një zyrtar ligjor në Shkurt 2013 dhe një asistente administrative në Mars 2013. Për të përmbushur kërkesat e Ligjit të ri për Prokurim Publik, OSHP ka punësuar dy ekspert shqyrtues më 20 Mars, 2013. OSHP ka punësuar gjithashtu edhe 11 ekspertë më 09.11.2012. Është e rëndësishme të theksohet se këta ekspert nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune, por angazhohen sipas nevojës së OSHP-ës, atëherë kur natyra e lëndës apo e ankesës ka të bëjë me çështje apo specifika teknike për të cilat ekspertët e brendshëm shqyrtues nuk kanë njohuri të mjaftueshme.

Në vazhden e ngritjes së kapaciteteve, trajnimi bazik për prokurim publik për vitin 2013 ka filluar më 12 Prill dhe do të përfundoj më 3 Maj. Përfitues të këtij trajnimi do të jenë afërisht 50 deri 55 zyrtar. Organizator të trajnimit janë KRPP dhe IKAP. Gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2012, saktësisht më 16 Nëntor ka filluar trajnimi i avancuar për prokurim publik, dhe ka zgjatur deri më 5 Dhjetor. Këtë trajnim e kanë ndjekur 499 zyrtarë të prokurimit nga të gjitha autoritetet kontraktuese të Kosovës.

Që nga Janari 2013 deri në Prill 2013 janë bërë 3 monitorime sipas planit dhe 2 monitorime sipas kërkesës nga Departamenti për Monitorim dhe Mbikëqyrje në KRPP. Sa i përket procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë, nga data 1 Janar deri 31 Mars, 2013 janë gjithsej 84 njoftime për procedurë në fjalë. Për të njëjtën periudhë kohore në bazë të kërkesave me shkrim të organeve përgjegjëse për ndjekje të rasteve të dyshuara, KRPP u ka ofruar gjithsej 14 interpretime.

Në periudhën tetor-dhjetor 2012, KRPP ka përfunduar monitorime të rregullta në 6 autoritete kontraktuese si dhe monitorime sipas rastit në 3 autoritete kontraktuese. Gjatë periudhës së njëjtë, janë përfunduar 56 monitorime me qëllim të përmirësimit të njoftimeve të publikuara të autoriteteve kontraktuese në faqen elektronike të KRPP-së.

Sa i përket rritjes së transparencës së proceseve të prokurimit publik, për periudhën raportuese 01.01.2013 deri më 30.03.2013, OSHP ka pranuar gjithsej 74 ankesa të operatorëve ekonomik. Prej tyre 54 janë shqyrtuar nga OSHP, kurse 20 janë në shqyrtim e sipër. 35% të ankesave të shqyrtuara kanë shkuar në favor të operatorëve ekonomik, ndërsa në favor të Autoriteteve kontraktuese 38% dhe pjesa e mbetur prej 27% janë ende në proces për tu shqyrtuar.

### **3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit**

Dispozitat për cenimin e të Drejtave të Autorit dhe shmangia e masave teknologjike janë futur në Kodin Penal, i cili hyri në fuqi më 1 Janar, 2013. Strategjia Kombëtare kundër Piraterisë dhe Falsifikimeve 2012-2016 u miratua më 4 Tetor, 2012 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia është hartuar nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe Zyra për Pronësi Industriale, Dogana e Kosovës dhe institucione tjera kompetente. Synimet kryesore të strategjisë janë ulja nivelit të piraterisë dhe falsifikimit, rritja e produktivitetin në industrinë kreative, dhe identifikimi i shkaqeve kryesore të rritjes së piraterisë dhe falsifikimit.

Sa i përket zhvillimeve institucionale, më 30 Janar, 2013 është themeluar Task Forca Kundër Piraterisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Task Forca përbëhet nga Zyra për të Drejtat e Autorit, Zyra për Pronësi Industriale dhe institucione tjera kompetente. Misioni kryesor i saj është zbatimi i Strategjisë kundër Piraterisë dhe Planit të Veprimit. Plani i veprimit koordinon aktivitetet e institucioneve kompetente për luftën kundër piraterisë, organizimin e fushatave vetedijesuese për të drejtat e autorit, pasojat e piraterisë, dhe të propozoj legjislacion mbi zbatimin e Strategjisë kundër piraterisë. Po ashtu në tetor të 2012 është themeluar Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave drejtuar kundër vendimeve të Zyrës për Pronësi Industriale (ZPI), i cili nga 19 Tetori 2012 e deri më tani ka shqyrtuar dhe vendosur 33 lëndë/ankesa. Ky komision përbëhet nga 3 anëtarë. Dy anëtarë janë të përhershëm, janë të emëruar nga Ministria dhe janë punëtorë të MTI-së ndërsa anëtari i tretë përzgjidhet në baza ad hoc dhe emërohet nga drejtori i ZPI-së.

Në funksion të rritjes së bashkëpunimit në fushën e pronësisë intelektuale, janë nënshkruar dy memorandume mirëkuptimi në mes të Zyrës për Pronësi Industriale dhe Zyrës për të Drejtat e Autorit (24.12.2012), në mes të Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe inspektoratit të tregut (28.01.2013). Ky i fundit parasheh zgjerimin e bashkëpunimit në mes të Inspektoratit të Tregut dhe Zyrës për të Drejtat e Autorit. Qëllimi i tij është përbushja e detyrimeve ligjore të ndërsjella në luftën kundër piraterisë dhe respektimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Dy zyrtar të ZPI kanë marr pjesë në një punëtori gjatë muajit Nëntor 2012 në Shkollën Rajonale për Administratë Publike në Mal të Zi në lidhje me zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale.

ZPI ka organizuar një seri të seminareve në Dhjetor 2012, nëpër 4 komuna të Kosovës në kuadër të fushatës vetedijesuese për komunitetin e biznesit. Pjesëmarrësit janë njoftuar me nocionin e patentave, markave tregtare, dizajnit industrial, procedurat e regjistrimit të tyre dhe mbi rolin e zyrës për pronësi industriale. Nga Shtatori 2012, ZPI ka publikuar 6 buletine bashkë me kërkesat/aplikacionet për regjistrim të objekteve të pronësisë industriale si dhe lëndët e regjistruara. Numri total i lëndëve të publikuara në këto Buletine është 4,728.

Sa i përket luftimit të mallrave të falsifikuara, Dogana e Kosovës për periudhën raportuese, ka intervenuar në 26 rase, për mallra nën dyshim se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale. Sasia e mallrave të ndaluara është 35,307 copë, me vlerë 158,430 euro. Vlen të përmendet që gjatë kësaj periudhe raportuese janë krijuar 3 profile të riskut të reja në lidhje me mallrat që cenojnë të drejtën e pronësisë intelektuale. Baza e të dhënave IPAS për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale është funksionale. Kjo bazë e të dhënave nga Shtatori 2012 është pasuruar me rreth 4500 lëndë, gjegjësisht objekte të pronësisë industriale.

### **3.1.7. Punësimi dhe politikat sociale**

Me qëllim të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, në shtator të vitit 2012 është aprovuar plotësim ndryshimi i Ligjit nr. 2012/04-L119 për Grevat. Po ashtu në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, është hartuar dhe aprovuar nga qeveria Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012, për kompensimin e shpenzimeve për lëndimet dhe sëmundjet profesionale të shkaktuar në punë. Në mënyrë që të sigurohet që politikat sociale të adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social në kuartalin e fundit të viti 2012 është aprovuar Ligji nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, si dhe është aprovuar Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për Përlllogaritjen e Shumës Mujore të Ndihmës Sociale.

Në vazhdim të zbatimit të politikave që lehtësojnë transferimin nga punësimi i paregjistruar në atë të regjistruar Inspektorati i Punës ka ndërmarr masa për zbatimin e Ligjit të Punës dhe luftimin e ekonomisë informale ku inspektorët e punës me rastin e inspektimeve, kanë shqiptuar masën



ndëshkimore ndaj 737 subjekteve. Ndërsa vetëm gjatë tremujorit të parë 2013 inspektorati i punës ka inspektuar gjithsej 1352 subjekte punuese si në sektorin privat edhe në sektorin publik. Në 539 subjekte është kryer inspektim i përsëritur. Në anën tjetër Inspektorati i Punës në këtë tre mujor ka realizuar 30 inspektime të përbashkëta me institucionet tjera të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale. Rezultat i inspektimeve në subjektet punuese në këtë 3 mujor është legalizimi i 814 punëtorëve dhe 66 subjekteve punuese.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe, në mënyrë që të bëhet përfshirja sociale dhe të merren masat kundër-diskriminimit për grupet e rrezikuara përfshirë edhe decentralizimin e shërbimeve sociale është aprovuar propozimi për themelimin e Komisionit për Mirëqenie, përfshirjen Sociale dhe Decentralizimin në bazë të Aktvendimit Nr.07/115, ku si rezultat i kësaj më 13.02.2013 është aprovuar Strategjia e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale 2013-2017 në bazë të vendimit nr. 06/11. Me qëllim të Zhvillimit të negociatave në mes të Republikës së Kosovës me shtetet e rajonit dhe të BE-së në fushën e sigurimeve sociale grupi punues i MPMS-së ka mbajtur takim në Podgoricë/ Mali i Zi, në mes Delegationit të Kosovës dhe të Mali të Zi. Gjithashtu është mbajtur takimi në mes Delegationit të Kosovës dhe Maqedonisë për harmonizimin e Marrëveshjes ndërmjet këtyre dy shteteve për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës në pension. Me datë 07.02.2013 në Prishtinë ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale i Republikës së Maqedonisë, nënshkruan Marrëveshje për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës në pension.

Gjithashtu, në kuadër të promovimit të dialogut social më 25-26 tetor 2012, dhe më 11-12 mars 2013 në Kroaci, anëtarët e KES-it, kanë marrë pjesë në punëtoritë me temën mbi Rolin e dialogut Social në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Me qëllim të vazhdimin të mbështetjes së OJQ-Strehimoreve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhe për viktima të trafikimit MPMS gjatë kësaj periudhe ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Organizatën Humanitare "Nënë Tereza".

Sa i përket forcimit të kapaciteteve administrative inspektorati i punës ka organizuar këto trajnime me të gjithë inspektorët e punës:

- Trajnim treditör me temën "Ushtrimi i Mbikëqyrjes Inspektive të Punëdhënësit në Subjektet Punuese";
- trajnimi në kohëzgjatje prej 5 ditë pune për 25 inspektor të punës, nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërsa 17 inspektorë të punës, janë trajnuar në fushën "parandalimi i formave të rrezikshme dhe të dhunshme të punës së fëmijëve dhe,
- trajnimi i 14 inspektorëve të punës në temën "anti-trafikimi me qeniet njerëzore." Veç kësaj janë rekrutuar edhe 5 inspektorë të punës.

Sa i përket kornizës ligjore në sektorin e Shëndetësisë gjatë periudhës raportuese janë miratuar Ligji për Shëndetësi më 13.12.2012 dhe Ligji për Duhanin i miratuar më 05.11.2012.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për komunitetin RAE dhe komunitetet tjera është veprim në vazhdim dhe është duke u realizuar nga institucionet shëndetësore në ato vendbanime ku është përqendruar ky komunitet dhe komunitetet tjera. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2013 janë testuar 30 raste të komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptas dhe janë marrë 13 mostra të gjakut kapilar 17 dhe mostra të gjakut venoz. Në kuadër të këtij aktiviteti janë të evidentuar 37 fëmijë të komunitetit Rom Ashkali Egjiptas të vaksinuar sipas kalendarit.

Implementimi i projektit të Metadonit është në vazhdim e sipër dhe numri i përfituesve aktual është 89 pacient.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore janë nënshkruar kontratat e para me QKUK-në dhe Spitalet Rajonale për shërbimet shëndetësore. Struktura e re e Ministrisë së Shëndetësisë është miratuar nga Ministria e Administratës Publike me 06.02.2013.

### **3.1.8. Arsimi dhe Hulumtimi**

Me 13.12.2012 Ligji për arsimin e të rriturve Nr.04/ L - 143 është miratuar (i harmonizuar me Ligjin për Kualifikime Kombëtare) si dhe nga Shtatori 2012 deri në Prill 2013 janë të miratuara 31 Udhëzime Administrative në funksion të zhvillimit të metutjeshëm të sistemit të arsimit përfshirë Zhvillim Profesional për Mësimdhënës (ZHPM), financimin, për performancën e mësimdhënësve, dhe profilin e kompetencave të mësimdhënësve (për detaje shih Aneksin V të bashkangjitur). Komiteti drejtues për mbikëqyrjen e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016 është themeluar në tremujorin e fundit 2012.

Për sigurim të cilësisë në sektorin e arsimit në tremujorin e fundit 2012 ka filluar zbatimi i Programit të Trajnimit dhe Licencimit të Mësimdhënësve të Arsimit Para-universitar ku njëmijë e pesëqind (1500) mësimdhënës janë rikualifikuar, si dhe mekanizmat dhe procedurat për funksionalizimin e procesit të licencimit janë funksionale dhe janë përfshirë në proces 19.000 mësimdhënës ku janë të përgatitura 24 qendra për ngritje profesionale dhe janë funksionale. Vetëm brenda periudhës 2012 janë trajnuar mbi 9.000 mësimdhënës ose 39%. Në kuadër të trajnimit dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve janë përfshirë në data bazë 20000 mësimdhënës që kanë marrë të drejtën për licencim si dhe janë akredituar 22 programe trajnimi për zbatimin e KKK nga Komisioni Evropian. Po ashtu, në muajin Mars 2013 janë përfshirë në programin ECDL 13964 mësimdhënës, prej tyre 51% janë certifikuar 4 module dhe 28% janë certifikuar për 7 modulet.

Për të përmirësuar qasjen në arsim në gjuhën e minoriteteve janë siguruar libri i historisë për klasën e 9 në gjuhën boshnjake si dhe libri i muzikës për klasën e 6. MASHT-i për vitin 2013 ka planifikuar buxhetin për krijimin e skemës për grante të bursave.

Me qëllim të rritjes së aktiviteteve kërkimore-shkencore gjatë periudhës tetor 2012-mars 2013 janë mbështetur 32 kandidat të studimeve të doktoratës jashtë vendit. Përmes projekteve të vogla shkencore sipas programit kombëtar të shkencës janë financuar 9 projekte, të cilat po ndihmojnë në aspektin e infrastrukturës kërkimore në arsimin e lartë. Deri tani në tremujori i parë 2013 Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA) ka akredituar 12 programe të doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Është mbajtur një trajnim pesë-ditor në zhvillimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare me komunitetin shkencor me 40 pjesëmarrës. Republika e Kosovës është pjesë mekanizëm ndërkombëtarë të shkencës dhe hulumtimit dhe merr pjesë në Kornizën e shtatë programore (FP7).

Gjate tremujorit të fundit 2012 për Zbatimin e Planit Strategjik 2010-2015 për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin para-universitar 40 mësimdhënës janë trajnuar për Metodologjinë e Punës në fusha të aktiviteteve dhe për Autizëm Veç kësaj është formuar grupi ndër-sektorial për zbatimin e dokumentit ndërkombëtar për Klasifikimin Ndërkombëtar të Aftësisë së kufizuar si dhe është pajisur shkolla për nxënësit me aftësi të kufizuara në Pejë dhe Prizren. Në Prishtinë është pajisur edhe një shkollë gjithëpërfshirëse me mjete të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve të institucioneve arsimore janë themeluar 3 Qendra për ngritje profesionale si dhe janë trajnuar 200 mësimsdhënës. Me qëllim të integritimit të mësimit elektronik në sistemin arsimor të Kosovës është krijuar Platforma Elektronike (KOS NET) dhe janë krijuar përmbajtjet pilot elektronike në tremujorit e fundit 2012.

Kosova ka vazhduar të përfitojë nga programet e BE-së për bursa dhe skema mobiliteti CEEPUS, TEMPUS, dhe Erasmus Mundus.

## **3.2. Politikat Sektoriale**

### **3.2.1. Industria dhe NVM-të**

Në lidhje me zhvillimet në sektorin e NVM-ve, është aprovuar Marrëveshja e Mirëkuptimit nga MTI në dhjetor të 2012 për Implementimin e projektit SVKT në bashkëfinancimin e projektit "Promovimi i NVM-ve në Kosovë" (KOSME) me Agjencinë e Austrisë për Zhvillim (ADA) dhe Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC). Lidhur me projektin Skema Voucher e Këshillimeve dhe Trajnimeve për Ndërmarrësi, ka përfunduar studimi i fizibilitetit me 15 Prill i cili është kryer nga ekspertët e projektit KOSME, parasheh që Shoqata e Konsulentëve ta bëjë kualifikimin e Këshilltarëve dhe Trajnerëve. Po ashtu në prill është kryer studimi i fizibilitetit për modalitetet e krijimit dhe funksionimit të Skemës së Garantimit të Kredive (SGK). Për më tepër, është kompletuar rrjeti energjetik dhe i trafo-stacionit të Parkut të Biznesit në Drenas duke i mundësuar parkut funksionim me kapacitet të plotë.

### **Agjencia për Promovimin e Investimeve**

Agjencia për Promovimin e Investimeve ka qenë e angazhuar në implementimin e masave të strategjisë për promovimin e investimeve 2011-2013 përfshirë këtu identifikimin e sektorëve atraktiv për investime dhe investitorëve potencial. Sektorët e identifikuar prioritarë janë: nënkontraktimi i punëve në qendrat për konsumatorë, agrobiznesi, përpunimi dhe paketimi i ushqimit, minierat dhe energjia, tekstili dhe përpunimi i lëkurës, përpunimi i drurit dhe metaleve, dhe turizmi. Në këtë kontekst, tashmë 5 kompani janë parakualifikuar për projektin e ri turistik të Brezovicës (Prill 2013).

Janë mbajtur një numër konferencash dhe forumesh në këtë periudhë raportuese përfshirë konferencat e mbajtura në Paris, Bursa, Budapesht, dhe Berlin, si dhe forumet me përfqësuesit e Zvicrës, Italisë, Francës, dhe Turqisë.

Gjithashtu përfaqësuesit e APIK kanë organizuar disa panairë përfshirë këtu panairin financiar të Shoqatës së Bankave të Kosovës, ExpoKos 2012, Natyra 2012, Panairi i Përgjithshëm 2012. Materialet promovuese të publikuara gjatë periudhës raportuese përfshijnë "Udhëzuesin si të investohet me sukses në Kosovë" bashkë me 16 publikime tjera të fokusuar në sektorët me potencial investues në secilën komunë.

### **3.2.2. Bujqësia dhe Peshkataria**

Duke pas parasysh rendësin dhe potencialin që ka sektori i bujqësisë për zhvillim ekonomik të vendit, autoritetet e Qeverisë së Kosovës kanë shënuar progres të mëtutjeshëm duke miratuar një numër të konsiderueshëm ligjesh:

- Ligji për Bujqësi Organike, Nr. 04/L-085 i miratuar, dekretuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/16 tetor 2012;
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i miratuar, dekretuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/16 tetor 2012;

- Ligji Nr. 4/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit, i miratuar, dekretuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 26/25 nëntor 2012;
- Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve, i miratuar, dekretuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 01/17/01/2013;
- Ligji për Regjistrimin e Bujqësisë Nr. 04/L-127, i miratuar, dekretuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 01/17 janar 2013.

Më qëllim të plotësimit të legjislacionit primar me atë sekondarë, MBPZHR, ka miratuar këto Udhëzime Administrative:

- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2012 për rregullimin e tokës të dt. 27.12.2012;
- Udhëzim Administrativ Nr. 07/2012 për metodologjinë e sqarimit të pronësisë në projektet e pa përfunduara të rregullimit të tokës të dt. 27.12.2012;
- Udhëzim Administrativ Nr. 08/2012 për vlerësimin e pjellorisë dhe përshtatshmërisë së tokës së përfshirë në projekt të rregullimit të tokës të dt. 27.12.2012;
- Udhëzim Administrativ Nr. 09/2012 për kriteret dhe përmbajtjen e marrëveshjes me shkrim të dt. 27.12.2012;
- Udhëzim Administrativ Nr. 10/2012 për kompensim financiar për drunjt, të mbjella dhe objekte tjera të paluajtshme në tokë të këmbyer të dt. 27.12.2012;
- Udhëzim Administrativ Nr. 12/2012 për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, të dt. 29.10.2012;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2012 të dt. 16.11.2012 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2012, të dt. 07.03.2012;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zonat rurale më pak të zhvilluara, datë 15/01/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 për caktimin e lartësisë së kompensimit material dhe shërbimet e kryera në lëmin e vreshtarisë dhe verëtarisë të ofruara nga Enti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë, datë 20/03/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2013, datë 22.03/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për pagesa direkt në bujqësi për vitin 2013, datë 22/03/2013.

Veç kësaj, gjatë kësaj periudhe të raportimit janë miratuar Rregulloret dhe Vendimet sa vijon:

- Rregullorja Nr. 01/2012 për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, datë 28.12.2012;
- Vendimi Nr. 04/119, për Themelimin e Komisionit Punues për Regjistrimin e Bujqësisë, datë 13/03/2013).

Sa i përket planeve dhe programeve, gjatë kësaj periudhe, është përgatitë Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2013 me masat 1, 2, 4, dhe 8 janë finalizuar. Me qëllim të hartimit të Strategjisë dhe Planit për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural (SPZHRB) 2014-2020., MBPZHR ka themeluar grupet punuese: Aftësinë konkurruese, Diversifikimin rural dhe LEADER, agro-ambient dhe zonat me pak të favorizuara.

Sa i përket, Regjistrimit të Bujqësisë, së bashku me Agjencinë e Statistikave, është finalizuar Pyetëtori dhe Udhëzuesi. Në Sistemin e Informimit të Tregut janë shtuar produktet bujqësore nga

230 ne 475 produkte bujqësore. Ka përfunduar certifikimi dhe kategorizimi për 64 lloje të verës. Me KASH 2013-2015, Buxheti i MBPZHR për vitin 2013 është me i lartë për 10.27% se ne vitin 2012. Ne vitin 2014 janë paraparë 31,859,230.00 Euro, ndërsa buxheti i njëjtë është paraparë edhe në vitin 2015 (31,859,230.00 Euro).

Sa i përket sektorit të pylltarisë, është realizuar formatizimi i Raportit të Inventarizimit Nacional të Pyjeve (RINP) Gjatë kësaj periudhe, Inspektorati qendror i pylltarisë (APK) për periudhën Tetor-Mars ka kryer 625 kontrolle në subjekte afariste, drejtori regionale, Komuna, tregje, qarkullime rrugore dhe në ngastra pyjore. Janë hartuar 300 procesverbale, 126 fletëparaqitje si dhe ka konfiskuar 308.68 m<sup>3</sup> masë drunore.

Në nivelin lokal, janë ngritur edhe 3,168 fletëparaqitje prej të cilave 2,183 kundërvajtëse me masë drunore 3,124.32 m<sup>3</sup> me dëmin e shkaktuar prej 340,393.40 Euro, ndërsa 985 fletëparaqitje janë penale për masën drunore 4,759.82 / m<sup>3</sup>. Për me tepër, nga Gjykata janë lëshuar aktvendime pozitive për 452 vepra kundërvajtës dhe 174 vepra penale. Janë pezulluar 262 lëndë (248 kundërvajtëse dhe 14 penale) ndërsa i ka refuzuar 39 lëndë (4 penale dhe 35 kundërvajtëse). Sasia e dëmit sipas këtyre vendimeve gjyqësore në total është 1,690.70 m<sup>3</sup>, ndërsa shprehur në vlerë monetare prej, 129,406.83 Euro.

Regjistri elektronik i fermerëve (REF) është rifreskuar, ndërsa deri në këtë periudhë, në sistem janë futur 24,376 fermerë. Sa i përket Sistemit të Thjeshtëzuar të Identifikimit të Parcelave, deri me tani janë përfshirë 37 komuna. Numri i parcelave të digjitalizuar në Sistemin e Informativ të Thjeshtëzuar të Parcelave është 49,063 me një sipërfaqe 53,854.19 ha, dhe krahasuar me vitin 2012, përqindja e aplikimeve është rritur përafërsisht 30 %.

Sa i përket reformave institucionale dhe themelimit të strukturave të reja institucionale, është themeluar Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike ( me 02.10.2012) dhe Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë me Rregulloren Nr. 01/2012 për detyrat, përgjegjësitë, kompetencat dhe strukturën organizative (me 28.12.2012).

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve institucionale, në tremujorin e parë të 2013 në Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP) janë trajnuar pesë zyrtar të MBPZHR për sektor të ndryshëm, ndërsa 82 zyrtar të komunave, OJQ-ve dhe fermer, kanë marrë pjesë në trajnime në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të organizuara nga MBPZHR. Për veç kësaj janë organizuar 17 ditë trajnime për shërbime këshillimore për 30 Këshilltarë komunal. Janë përgatitur 7 botime dhe janë mbajtur 70 konsultime me fermerët në shumicën e komunave të Kosovës.

Sa i përket informimit për grande dhe subvencione, përmes këshilltarëve komunal, janë informuar rreth 11,000 fermer si dhe janë shpërndarë 3,000 broshura "Programi për Zhvillim Rural 2013" në të gjitha komunat e Kosovës, ndërsa për mbushjen e aplikacioneve për grande dhe subvencione janë përkrahur rreth 4,000 fermer. Bazuar në Programin për Zhvillimin Rural 2013, 525 fermerë janë trajnuar për metodologjinë e grandeve dhe subvencioneve, kurse Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në bashkëpunim me Grupin Norvegjez të Pyjeve ( GNP) ka afruar trajnime për pronarët e pyjeve private dhe aktoret tjerë me tri manuale: manuali për pylltari, manuali për trajtime në pyjet e reja të dushqeve dhe manuali për mirëmbajtjen e rrugëve pyjore.

## **Siguria e Ushqimit**

Me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ( AUV) ka aprovuar:

- Rregulloren Nr. 27/2012 " Për përcaktimin e Kritereve Mikrobiologjike në Ushqim (me 14.12.2012).
- Rregulloren Nr. 18/2012 " Për Importin e Qumështit të Papërpunuar" ( me 17.08.2012)

Sipas planit nacional të monitorimit të sëmundjeve dhe kontrollit të ushqimit, praktikat veterinare të kontraktuara nga AUV, sipas planit nacional për mostrim, janë mbledhur 1,930 mostra të gjakut të cilat janë dërguar për analiza laboratorike në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë të AUV. Mostrat e gjakut janë marr nga kafshët e këtyre komunave: Gjilan, Istog, Kamenicë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Pejë dhe Podujevë bazuar në planin nacional për vitin 2013. Përveç kësaj, janë bërë analizat laboratorike për dyshimin në sëmundjen e Brucellozës, Enterotoksemi dhe Klamidiozë. Kështu që janë asgjësuar gjithsej 43 dhi dhe një lopë të cilat kanë rezultuar pozitiv në sëmundjen e Brucellozës.

Sipas raporteve dhe sistemit të lajmërimit të sëmundjeve në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë, janë analizuar të gjitha mostrat e kafshëve të cilat ishin konsideruar si të dyshimta në sëmundje. Po ashtu në tremujorin e parë të këtij viti (2013) ka përfunduar testimi i 99 mostrave për analiza mikrobiologjike, ndërsa 500 mostra në Laboratorin e kimisë ushqimore për prezencën apo mos prezencën e Aflatoksines të produkteve të importuara dhe produkteve nga prodhuesit vendor.

Sa i përket, zhvillimit të projektit për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të nënprodukteve shtazore, AUV ka siguruar buxhetin për vitin 2013 në vlerë prej 1,000,000 Euro. Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë (LUV) është furnizuar me pajisje për analiza të monitorimit dhe diagnostifikimit të sëmundjeve të kafshëve si dhe me pajisje për analiza të mbetjeve në ushqim për analiza konfirmative. AUVK ka filluar kontrollin e tregjeve të kafshëve për licencimin e tyre në gjithë territorin e Kosovës. Me qëllim të informimit me të mirë të opinionit, janë përgatitur fletëpalosjet, aplikacioni për licencim, njoftimet për mjetet e informimit dhe bilbordat të cilët do të vendosen në hyrje të tregjeve të kafshëve e të cilat i kanë për obligim informimin për rregullat e shitjeve dhe blerjeve si dhe lëvizjen e kafshëve. Deri më tani janë inspektuar gjashtë (6) tregje të kafshëve.

Gjatë kësaj periudhe, janë aprovuar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për : a) marrje të mostrave; b) PSO e përgjithshme dhe c) PSO për marrje të mostrave për mbetje. Gjatë kësaj periudhe në bazën e të dhënave të I&R nga terreni janë raportuar këto të dhëna:

- Lëvizje-8140 gjedhe dhe 6021 dele;
- Lindje-73513 gjedhe dhe 43550 dele, dhi dhe derra;
- Therje - 1083 gjedhe; dhe
- Import - 2957 gjedhe.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së stafit të punëtorëve, gjatë kësaj periudhe në AUV janë pranuar 20 punëtorë). AUV, ka përgatitë planin e trajnimit për vitin 2013, ndërsa deri me tani janë trajnuar 26 inspektorë fitosanitar për fushën fortifikimit të miellit. Veç kësaj janë trajnuar tetë (8) inspektor veterinarë për kontrollin e therjes dhe dhjetë (10) Inspektor veterinar për mbetjet veterinare. AUV, ka kontraktuar 28 praktika veterinare për kryerjen e shërbimeve veterinare në teren sipas planit për vitin 2013.

### 3.2.3. Mjedisi

Në fushën legjislative, MMPH ka vazhduar procesin e plotësimit të kornizës ligjore duke miratuar këto ligje:

- Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri" është miratuar në Kuvend me datën 13.12.2012, Dekreti -nr. DL-59-2012, (datë: 26.12.2012);

- Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është miratuar në Kuvend me datën 13.12.2012, Dekreti -nr. DL-60-2012, (datë: 26.12.2012);
- Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës i miratuar me 19.03.2013, Dekreti nr. DL-11-2013, (datë: 05.04.2013).

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë miratuar këto udhëzime administrative:

- U.A Nr. 22/2012, mbi Taksat Administrative për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit & Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, (datë: 19.11.2012);
- U.A Nr. 23/2012, për Menaxhimin e Gomave Jashtë Përdorimit dhe Mbeturinave të Gomës, (datë: 05.12.2012);
- U.A Nr. 24/2012, për Përmbajtjen, Formën dhe Mënyrën e Lëshimit të Kartës Identifikuese si dhe dukjen e Uniformës të Mbikëqyrësit dhe Rojtarit të Natyrës, (datë: 05.12.2012);
- U.A Nr. 25/2012, për Leje Mjedisore, (datë: 10.12.2012);
- U.A Nr. 26/2012, për Qarkullimin Ndërkufitar dhe Tregtinë me Llojet e Egra të Mbrojtura, (datë: 10.12.2012);
- U.A Nr. 15/2012, për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave i miratuar në Qeveri, (datë: 07.12.2012).

Në proces të implementimit të legjislacionit në fuqi dhe politikave mjedisore, 4 komuna kanë miratuar Planet Zhvillimore Komunale -PZHK dhe Planet Zhvillimore Urbanistike -PZHU. Krahas kësaj, pasi që një pjesë e kompetencave për menaxhimin e mbeturinave ka kaluar edhe tek komunat, deri më tani janë hartuar dhe miratuar 13 plane lokale të veprimit për menaxhimin e mbeturinave (Prishtinë, Hanit të Elezit, Viti, Deqan, Junik, Pejë, Malishevë, Gracanice, Kllokot, Ranillugë, Partesh, Novobrd dhe Kamenicë).

Sa i përket implementimit të U.A Nr. 19/2012 "Për menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponenteve të tyre" inspektorati i MMPH ka bërë 13 inicime në gjykatë me anë të të cilave ka adresuar vrejjet e inspektorëve dhe dukshëm ka përmirësuar nivelin e implementimit nga shumica e operatorëve.

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit është funksionalizuar edhe me tri stacione fikse të monitorimit të cilat janë të vendosura në zonën e KEK-ut (Obiliq, Dardhishte dhe Palaj-KosovaMont) të cilat tani janë në funksion dhe marrin të dhëna për gjendjen e ajrit në atë zonë. Ndërsa, si pjesë e Sistemit të Përbashkët të Informimit për Raportimin Mjedisor (SERIS), janë postuar në portalin e EEA/EIONET, Raporti për Gjendjen e Ajrit dhe Raporti për Hotspotet Mjedisore, dhe poashtu në Agjencionin Evropian të Mjedisit është dërguar edhe Raporti për Zonat e Mbrojtura, kurse përmes EEA është raportuar në UNECE dhe për emisionet në Ajër (CLRPT/EMEP). Rezultatet preliminare të 2012-2013 të publikuara në EEA konfirmojnë që Kosova dukshëm ka përmirësuar kualitetin e raportimit (<http://www.eionet.europa.eu/datflows/pdf2012/>).

Në fushën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore, MMPH ka vazhduar me trajnimet e programit RENA, ku janë trajnuar 3 zyrtarë në fushën VNM/VSM, dhe 2 zyrtarë nga fusha për planifikim të investimeve dhe zhvillim të planeve financiare. Sa i përket ndryshimeve klimatike, 3 zyrtarë kanë përfituar nga workshopet "Ndërtimi i njohurive dhe llogaritja e kuotave për skemën EU ETS" (25 tetor 2012), dhe "Krijimi i njohurive dhe kapacitetet e vendeve përfituese nga RENA për përmirësimin e inventarit të gazërave serë brenda skemës MMD" (26 tetor 2012).

Me qëllim të fuqizimit të implementimit të politikave mjedisore, MMPH i ka kushtuar rëndësi trajnimit të inspektoratit në fushën e inspektimit ndërkuftar për mbrojtjen e natyrës, krimet mjedisore, procedurat inspektuese mjedisore si dhe lejet e integruara mjedisore. Për me tepër, në bashkëpunim me Swedish Chemicals Agency (KEMI) të Suedisë, ka marrë pjesë dhe është trajnuar 1 inspektorë në programin e trajnimit ITP 299 EU me temë “Strategjia e Menaxhimit të Kimikateve”.

Po ashtu, me qëllim të informimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në proceset planifikuese, MMPH ka mbajtur dy seminare: Seminari Kombëtar për Ndryshimet Klimatike - Mundësitë, Përfitimet dhe Sfidat e Politikave dhe Legjislacionit të BE-së në kuadër të Rrjetit Rajonal Mjedisor për Integrim (Tetor, 2012), dhe Treyzën Tematike për -Strategjinë për Integrim Evropian në fushën e Mjedisit (Nëntor, 2012).

### **3.2.4. Politika e Transportit**

Sa i përket zhvillimeve operationale në sektorin e aviacionit civil, Kosova ka vazhduar të përshtat legjislacionin e Aeronautikës (aviacionit acquis) në kuadrin e saj ligjor. Si rezultat, rregullore të cilat kanë hyrë në fuqi në periudhën raportuese janë si më poshtë:

- Rregullorja 1/2013 e MI-se që transponon Rregulloren (KE) nr. 80/2009 mbi Kodin e sjelljes për sistemet e kompjuterizuara të rezervimit;
- Rregullorja 2/2013 e MI-së që transponon Rregulloren (KE) nr. 1107/2006 lidhur me të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar gjatë udhëtimit nëpërmjet ajrit;
- Rregullorja 5/2012 e AAC-së që transponon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 805/2011 për vendosjen e rregullave të hollësishme mbi licencën e kontrollorëve të trafikut ajror dhe certifikimeve tjera;
- Rregullorja 6/2012 e AAC-së që transponon Rregulloren Implementuese të Komisionit (EU) Nr. 1034/2011 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror;
- Rregullorja 7/2012 e AAC-së që transponon Rregulloren Implementuese të Komisionit Nr. 1035 /2011 për vendosjen e kërkesave të përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;
- Rregullorja Nr. 01/2013 e ARH për Deklaratën e Rrjetit

Në kontekst të zhvillimeve në fushën e aviacionit civil, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) ka vazhduar shqyrtimin e aplikacionit të pranuar nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror (OSHNA) për certifikim sipas standardeve të BE-së.

Për me tepër, nga 23-25 tetor, AAC-ja është audituar nga ekipi i auditorëve të Programit ISIS (program i Komisionit Evropian - Implementimi i legjislacionit të qiellit të vetëm evropian në Evropën Juglindore). AAC-ja ka arritur të hartojë dokumentacionin e nevojshëm dhe të zbatojë rregulloret e aplikueshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e trafikut ajror në nivel pothuajse të njëjtë me shtetet anëtare të BE-së. Në shkallën prej 1 deri në 10 të indikatorëve të performancës, auditorët vlerësuan AAC-në me 9,5. Si rrjedhojë e zbatimit të Marrëveshjes ECAA dhe liberalizimit të tregut, numri i udhëtarëve gjatë vitit 2012 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ka qenë 7,37% më i madh se në vitin 2011. Ndërsa, në tremujorin e parë të vitit 2013 është shënuar rritje trafiku prej 19%.

Në sektorin e transportit rrugor, , Këshilli për Siguri në Komunikacionin rrugor ka mbajtur takimin e radhës me 06 shtator 2012. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes sa i përket sigurisë në komunikacionin rrugor, është duke vazhduar fushata për Siguri në Komunikacionin Rrugor në shkolla fillore me



ç'rast janë shpërndarë 4000 Broshura dhe 20000 fletëpalosje për siguri rrugore. Sa i përket zhvillimeve në sektorin e hekurudhave, bazuar në legjislacionin në fuqi Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) me 15 Nëntor 2012 ka lëshuar licencën për menaxherin e infrastrukturës - Infrakos dhe licencën për operim me trena - Trainkos Po ashtu, në fushën e sigurisë, ARH me 24 Janar 2013 ka lëshuar autorizimin e sigurisë për Infrakos dhe Certifikatën e Sigurisë për Trainkos. Duke pasur parasysh bashkëpunimin ndërkombëtar, ARH ka marrë pjesë në takimin e Autoriteteve të Sigurisë Kombëtare të organizuar nga Agjencia Evropiane Hekurudhor (ERA), nga 19-22 shkurt në Lille, Francë. Në anën tjetër, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore (KHAIA) për herë të parë ka marrë pjesë në takimin e organeve nacionale të hetimit të aksidenteve hekurudhore të organizuar nga Agjencia Evropiane e Hekurudhave (National Investigation Bodies Meeting organized by European Railway Agency, 12- 13 mars 2013 Lile, France). Ndërsa, në fushën e bashkëpunimit evropian sa i përket hetimit të aksidenteve dhe incidenteve të sigurisë së aviacionit civil KHAIA ka marrë pjesë si vëzhgues në 2 takimet e rregullta të Rrjetit Evropian të Autoriteteve Hetuese të Sigurisë së Aviacionit Civil (European Network of Civil Aviation Safety Investigation Authorities) të mbajtura me 13-14 shtator dhe 31 janar - 1 Shkurt 2013 në Bruksel. KHAIA është anëtare në cilësinë e vëzhguesit, e barabartë me vendet tjera jo anëtare të BE-së, në këtë rrjet Evropian.

Në kontekst të intensifikimit përpjekjeve të anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, nga shkurti i vitit 2013. MI nga anëtarit vëzhgues ka kaluar në anëtar të plotë të CITA-s (Komiteti ndërkombëtar për kontroll teknike të automjeteve). Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, MI ka marr pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga SEETO.

Sa i përket sinjalizimit vertikal dhe horizontal të rrugëve, projekti është në realizim e sipër, deri me tash është realizuar në masën 70 %. Ndërsa sa i përket zbatimit të standardeve për rregullin teknik të veturave, 2010 automjete nuk e kanë kaluar testin e rregullsisë teknike. Po ashtu, janë lëshuar 49 licenca në transportin e mallrave, 3 në transportin e mallrave të rrezikshme dhe 2 në transportin e udhëtarëve, ndërkaq sa i përket transportit të brendshëm të udhëtarëve, janë lëshuar 1069 autorizime si dhe janë nënshkruar 3 kontrata për transport të subvencionuar.

Në vazhden e implementimit të projektit të R7, kanë përfunduar në tërësi punimet në segmentet 1-6, 59 km të përfunduara, ndërkaq janë duke u zhvilluar punimet në segmentin 8, punimet kanë përfunduar në masën 9 % si dhe në segmentin 9 realizimi është 17%. Ndërkaq segmenti 7 është në proces të shpronësimit. Me tej, pas Vendimit të Qeverisë për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërmintrosor për Autostradën R6, Segmenti Prishtinë - Hani i Elezit, MI ka kryer përgatitjet e nevojshme për realizimin e këtij projekti strategjik. Si rezultat ka filluar punën Këshilltari për Shërbime të Transaksioneve për Projektin e Autostradës R6.

Sa i përket implementimit të programit të mirëmbajtjes së rrugëve, janë mirëmbajtur 3.1925 km rrugë magjistrale dhe regionale ( mirëmbajtja Verore dhe Dimërore ), si dhe seksioni 1 - 5 i autostradës. Për me tepër, janë nënshkruar 20 kontrata për projekte kapitale, me ç'rast kanë përfunduar në tërësi 3 projekte, si dhe 17 projekte do të përfundojnë gjatë këtij viti. Për me tepër, në drejtim të zgjerimit të rrugës nacionale N2 Prishtine - Mitrovicë kanë përfunduar 7.5 km, si dhe zgjerimi i rrugës nacionale N9 Prishtine - Pejë, 8 km të përfunduara. Po ashtu, fondet për mirëmbajtje të rrugëve magjistrale dhe regionale si dhe për autostradë janë të siguruara.

Në kontekst të ngritjes së kapaciteteve profesionale në ARH, ka punësuar tre zyrtar të rinj. Ndërkaq, në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale sa i përket transportit rrugor, janë trajnuar dhe certifikuar me certifikatë CPC 196 shofer në transportin e mallrave dhe 61 shofer në transportin e

udhëtarëve. Po ashtu, janë certifikuar dhe trajnuar 38 shofer me certifikatë të ADR-ës në transportin e mallrave të rrezikshme. Ndërkaq, prej 15 deri më 19 prill në TÜV AKADEMI në Ulm të Gjermanisë pesë zyrtarë janë certifikuar si trajner të ECO ngasjes. Për më tepër, prej 10 deri më 16 nëntor 2012 dhe prej 24 shkurt deri më 02 Mars 2013 tetë (8) persona janë trajnuar në Lubjanë (Slloveni) si dhe Unterneukirchen (Gjermani) në qendrën trajnuese për kontrollimin e gazrave. Ndërsa, në fushën e sigurimit të aviacionit civil, dy inspektore të MPB prej 22 deri më 26 prill kanë marr pjesë në trajnime të IATA-s për "Sigurimin e Mallrave në Transportin Ajror" në Gjenevë.

### **3.2.5. Energjia, përfshirë sigurinë bërthamore**

Konsideruar rëndësinë e zhvillimit të sektorit, Qeveria e Kosovës ka shënuar progres më tutje në kornizën ligjore për energjinë, siç është aprovimi i Udhëzimeve Administrative (UA) si më poshtë:

- UA nr 01/2013 për caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), aprovuar më 31 janar 2013;
- UA nr 14/2012 në promovimin e efikasitetit të energjisë (EE) tek përdoruesit fundor dhe shërbimet energjetike, aprovuar më 31 tetor 2012;

Që nga tetori 2012, Agjencia Kosovare për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB) nuk është më pjesë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), por tani operon e pavarur brenda Zyrës së Kryeministrit. Si pjesë e zhvillimit institucional, në muajin dhjetor 2012 stafi i kësaj Agjencie (tre) kanë vijuar trajnimin për menaxhimin e mbeturinave radioaktive duke përfshirë edhe rrufepitësit radioaktiv (në kuadër të projektit regional të IPA-së për Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë).

Sa i përket zhvillimeve tjera institucionale, me vendim të Qeverisë më 19 shtator 2012, janë themeluar tre grupe punuese për dekomisionimin e TC Kosova A. Këto grupe do ta hartojnë procesin e dekomisionimit, vlerësimin në aspektin social dhe vlerësimin financiar. Këto grupe tanimë kanë hartuar planet e tyre të punës për vitin 2013. Më 17 dhjetor 2012, me vendim të Qeverisë është aprovuar Rregullorja për funksionim të brendshëm të Ministrisë për Tregti dhe Industri (MTI-së). Kjo rregullore parashihet themelimin e njësisë/divizionit për rezerva të obligueshme të produkteve të naftës brenda Departamentit Shtetëror për Rezerva të Mallrave.

Dizajni i Tregut të brendshëm të energjisë elektrike është finalizuar dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) në mars të këtij viti. Sidoqoftë, rregullat e tregut do të aprovohen në kvartalin e dytë të këtij viti. Gjatë periudhës raportuese, Bordi i ZRRrE-së ka lëshuar tre autorizime fillestare për këto kapacitetet gjeneruese nga BRE-të:

- 3.2MW hidro central
- 9.85MW hidro central, dhe
- 30MW me erë

Gjatë periudhës gjashtë mujore, gjegjësisht dhjetor 2012 - prill 2013, Komiteti Drejtues i Projektit "TC Kosova e Re" dh shqyrtuar Kërkesën për Propozime dhe Draft marrëveshjeve, përderisa më 5 prill është bërë aprovimi dhe shpallja e tyre.

Gjatë periudhës raportuese, AKMRrSB-ja ka filluar me procedurat e licencimit dhe autorizimeve dhe ka lëshuar si më poshtë:

- Tre autorizime për Operator te ndryshëm për aktivitete në fushën e menaxhimit të mbeturinave radioaktive;

- Ka lëshuar tre leje për dy operatorë: njërit për transportimin e burimeve radioaktive dhe për përdorimin e burimit radioaktiv në radioagrafi industriale për qëllime të KEK-ut në nëntor 2012, dhe tjetrit operator për transportimin e burimit Cs-137, prill 2013;
- Ka lëshuar një leje Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për përdorimin e këtyre burimeve, prill 2013.

Deri në fund të muajit mars 2013, Operatori i Sistemit të Tregut dhe transmissioinit, KOSTT me sukses ka realizuar projektet në ngritjen dhe përmirësimin e rrjetit. Ngritja dhe zhvillimi përfshijnë si mëposht:

- Paket Projekti SS 110/20(10) kV Gjilani 5 me linja transmetuese;
- Paket Projekti SS 110/20(10) kV Palaj me linja transmetuese;
- Paket Projekti SS 110/20(10) kV Prishtina 7 me linja transmetuese 110 kV;
- Zëvendësimi i pajisjeve të tensionit të lartë në NS 400/220 kV Kosova B në nivelin 400kV.

Sa i përket cilësisë së ajrit në zonat e TC-ve, gjatë kvartalit të fundit të vitit të kaluar janë montuar tre pajisje për monitorim të ajrit. Këto pajisje/stacione më tutje i janë transferuar Agjencisë Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit. Të dhënat e mbledhura nga Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës më tutje do t'i dorëzohen Ministrisë për Zhvillim Ekonomik (MZHE-së) për projektin e TC Kosova e Re.

KEK-u me sukses ka përfunduar projektet e instalimit të Elektro Filtrave në bloqet e TC Kosova A; njërin në A5 në muajin shtator, dhe tjetrin në A3 në muajin dhjetor 2012. Sipas sistemit monitorues të KEK-ut, limit i emetimit të pluhurit ka rënë në 50 mg/Nm<sup>3</sup>.

Më tutje, MZHE-ja ka zbatuar me sukses projekte për EE dhe BRE-të, siç janë projekti i vetëdijesimit publik dhe konsumatorëve për EE dhe BRE-të, si dhe studimi për potencialin e biomasës për prodhimin e bio derivative. Të dhënat e kësaj të fundit mbi identifikimin e potencialit dhe skenarëve për prodhim të bioderivateve, zgjedhja e njërit i cili do të shërbejë për zbatimin e obligimeve, pra të Direktivës 2009/28/EC. Projekt tjetër i zbatuar me sukses është ai i auditimit të energjisë në ndërtesa publike, ku përmes të cilit audituar 48 gjatë vitit 2012.

Njësia për Zbatim të Projektit (NjZP) të bashkë-gjenerimit TC Kosova B dhe Termokos ka kryer disa aktivitete të rëndësishme, si më poshtë:

- Ka hartuar dhe aprovuar elaboratin e shpronësimit, i cili më tutje (Njësia për Zbatim të Projektit). Lënda është dorëzuar në Komunën e Prishtinës për procedura të mëtutjeshme për shpronësim;
- Ka aprovuar projektimet për ndërtimin e dy stacioneve kyçëse, atë të nxjerrjes së nxehtësisë dhe të pranimit të nxehtësisë, njërin në TC Kosova B dhe tjetrin në Termokos;
- Ka përzgjedhur kontraktuesin për shtrimin e tubacioneve të ngrohjes nga Termokos deri në TC Kosova B.

### **3.2.6. Shoqëria Informative dhe Media**

Në kontekst të kompletimit të kornizës legislative primare, Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 04 Tetor 2012. Sa i përket kornizës ligjore sekondare, me 21 qershor 2012 (Vendimi nr. 221) është miratuar rregullorja për llogaritjen e kostove sipas modelit FDC nga Bordi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Sa i përket krijimit dhe implementimit të politikave të përshtatshme për zhvillimin e shoqërisë informative, dokumenti strategjik "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda

Digjitale për Kosovë 2013-2020" është miratuar nga Qeveria me Vendim Nr. 02/119 të datës 13 mars 2013. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës me 24 tetor 2012 ka miratuar vendimin (No. 04/88) për liberalizimin e mëtejshëm të shërbimeve të telefonisë mobile, ndërsa me 29 tetor 2012 ka miratuar vendimin (No.01.89) për aprovimin e shenjës Z6 si shenjë e thirrjes për shërbime Radio Amatore në tërë hapësirën gjeografike të Republikës së Kosovës.

Si rezultat i përfundimit të analizën e tregjeve për telefonin fikse dhe mobile, Bordi i ARKEP me 27 Mars 2013 ka miratuar fillimin e këshillimit publik të draft raportit të përgatitur nga Grupi Punues për analizën e tregjeve të linjave me qira dhe pas përfundimit të këshillimit pritet të hiqen obligimet në këto tregje për OFNT. Sa i përket zhvillimeve në fushën e radio frekuencave, plani i përdorimit të radio frekuencave është miratuar me 28 Shkurt 2013 nga Bordi i ARKEP si dhe njëkohësisht është hartuar plani për monitorimin e shfrytëzimit të radio frekuencave.

Sa i përket zhvillimeve në fushën e interoperabilitetit për ndërveprueshmërinë e sistemit të TIK, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Korniza e Interoperabilitetit me 13 shkurt 2013 me nr. 08/115.

Sa i përket zhvillimeve institucionale në fushën e medie, në kuadër të procesit të kompletimit të emërimit të anëtareve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), Kuvendi i Kosovës me 10 shkurt 2013 ka emëruar edhe një anëtarë të KPM, nga radhët e komunitetit serb duke emëruar 6 nga 7 anëtarët që duhet të ketë KPM. Ndërsa me 5 nëntor 2012, Kuvendi i Kosovës zgjodhi 3 anëtarë e Bordit për Ankesa të KPM.

Sa i përket vendimeve dhe rekomandimeve të lëshuara gjatë periudhës raportuese, KPM ka marrë 33 vendime ndaj subjekteve transmetuese. Nga këto, 14 vendime për licencim, 5 vendime për ndryshimin e emrit, 4 vendime për ndryshimin e pronësisë, 2 vendime për revokimin e licencës, 6 vendime për refuzim të kërkesave, 3 vendime për ndryshimin e lokacionit, dhe 3 vendime për raste ligjore - shkelje e Ligjit të KPM. Gjithashtu KPM ka marrë vendim të publikojë listën me frekuenca të lira për radio dhe TV lokale.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-ut, një numër aktivitete janë realizuar nga ARKEP duke marr pjesë në trajnim dhe vizita të ndryshme si me poshtë:

- Dy zyrtarë nga ARKEP nga kanë vazhduar vijimin e Trajnimit të Shkollës Rregullatorë pranë Shkollës Evropiane për Rregullatorë të Telekomunikacionit të organizuar nga Rober Schuman Center for Advanced Studies në Firenzë, Itali (15 -19 tetor 2012; 6 - 8 dhjetor 2012; 14 - 16 shkurt 2013; 18 - 20 prill 2013);
- Tre zyrtarë nga ARKEP kanë marrë pjesë në trajnimin për ekspozimin ndaj valëve elektromagnetike prej, në Gjermani (4 - 6 mars 2013);
- Dy zyrtarë të ARKEP kanë marrë pjesë në Panairin ndërkombëtar CeBiT në Hanover, Gjermani (7 - 8 mars 2013);
- Tre zyrtarë të administratës së ARKEP kanë marrë pjesë në trajnimin për Financa në Dubrovnik, Kroaci (28 - 31 mars 2013);
- Vizitë studimore e ARKEP-se rreth autorizimeve të përgjithshme dhe regjistrimit për mbikëqyrjen e tregut në Riga, Letoni (pjesëmarrës tre zyrtarë, 22 - 24 janar 2013);
- Tre zyrtarë të ARKEP kanë marr pjesë në punëtorin e Ekspertit të TAIEX (eksperti nga Belgjika: Mr. Jan Vannieuwenhuyse BIPT, Belgium) rreth përgatitjes së rregullores për rregullat e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (28 janar deri me 1 shkurt 2013);
- Tre zyrtarë të ARKEP kanë marr pjesë në vizitën studimore për Monitorimin e Spektrit Frekuencor në Riga, Letoni (11 - 13 mars 2013);

- Katër zyrtar të ARKEP-se kanë marr pjesë në vizitën studimore sa i përket rishikimit të rregullores për çmimet e spektrit frekuencor, Mision i Ekspertit nga TAIEK (2 ekspertë/trajnerë, Lituani (18 – 22 mars 2013));

Ndërsa, gjatë periudhës raportuese, një zyrtar i KPM nga 20 – 23 shkurt 2013 ka marr pjesë në trajnim për fushën e prokurimit publik dhe marrëdhëniet me publikun, në Tiranë.

### **3.2.7. Kontrolli Financiar**

Në funksion të zbatimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) në sektorin publik, në tremujorin e fundit të 2012 janë pranuar 54 raporte nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe janë përgatitur dhe shpërndarë tek organizatat buxhetore listat vet-vlerësuese të MFK-së.

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve të kontrollit financiar dhe auditimit të brendshëm, gjatë periudhës raportuese janë rekrutuar 9 auditorë të brendshëm, janë krijuar edhe tri njësi të auditimit të brendshëm si dhe janë themeluar 6 komitete të auditimit.

Gjithashtu, janë mbajtur tri trajnime dhe pesë seminare për të gjithë auditorët e brendshëm përfshirë auditorët e rinj (10 auditorë të rinj) dhe komitetet e auditimit për temat e planifikimi strategjik dhe vjetor, auditimit të proceseve të prokurimit dhe implementimi i rekomandimeve të auditimit si dhe një seminar për drejtorët e NJAB. Rreth 200 persona kanë marrë pjesë në këto trajnime.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka aprovuar planin vjetor të auditimeve dhe ka filluar me auditimet e rregullsisë për vitin 2012, me ç'rast janë përgatitur 75 memo të auditimit të cilat kanë për qëllim të prezantojnë këshillat e drejtorëve të auditimit dhe mënyrën se si janë adresuar rekomandimet e dhëna një vit më parë. Po ashtu është filluar me tri studime të reja të auditimit të performancës.

Sa i përket kapaciteteve të Zyrës së Auditorit të Jashtëm, në periudhën raportuese janë pranuar tre auditorë zëvendësues dhe 5 auditorë të përhershëm (janar 2013). Gjithashtu është rritur numri i auditorëve të certifikuar në gjithsej 25% e stafit auditor, dhe numri i kontabilistëve të certifikuar në gjithsej 28% e stafit auditor. Njëkohësisht, në periudhën tetor-dhjetor 2012 janë trajnuar 44 auditorë me gjithsej 56 orë trajnime në fushën e auditimit të jashtëm.

### **3.2.8. Statistikat**

Me qëllim të zhvillimit të institucionit dhe sistemit statistikor të Kosovës është aprovuar U/A nr. 08/2012, mbi mënyrën dhe kushtet e ofrimit të të dhënave statistikore të fituara me përpunime të veçanta të statistikave zyrtare, gjithashtu është aprovuar rregullorja për riorganizimin e ASK-së. Me qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të kualitetit të të dhënave statistikore në përputhje me standardet ndërkombëtare ASK ka përgatitur Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017 i cili është aprovuar nga Qeveria në pjesën e parë të vitit 2013.

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve për publikimin e statistikave të reja biznesore që janë në përputhje me nevojat e Kosovës dhe standardeve të EUROSTAT-it është aprovuar rregullorja nr. 11/2013 për implementimin e standardit për klasifikimin e veprimtarive ekonomike në versionin NACE-Rev.2, ASK ka filluar projektin e kalimit të klasifikimit të aktiviteteve ekonomike nga NACE Rev.1 në NACE Rev.2. Deri në momentin raportimit janë kryer 16,263 biznese apo rreth 65 % të mbledhjes së të dhënave në teren. Gjatë periudhës raportuese janë nxjerr tabelat me rezultatet preliminare nga Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2012 dhe përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë janë duke vazhduar.

Në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve, një zyrtar ka marrë pjesë në një trajnim afatgjatë në fushën e statistikave sociale moduli SILC. Përveç kësaj, janë mbajtur gjithsej 97 seminare, punëtori dhe vizita studimore nga 1 deri 10 ditore brenda periudhës Shatori 2012 - Mars 2013.

Gjatë periudhës raportuese janë publikuar aktivitete statistikore si në vijim:

- Është zhvilluar anketa në terren mbi remitanca gjatë muajit Dhjetor, 2012 dhe Janar, 2013 (projekt i mbështetur nga UNDP);
- Raporte statistikore mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë TM3 dhe TM4 2012, Statistikat e Transportit në Kosovë TM3 dhe TM4 2012, dhe Statistikat e Hotelarisë në Kosovë TM3 dhe TM4 2012;
- Janë bërë 8 publikime të statistikave të inflacionit siç janë: Indeksi i Çmimeve të Konsumit Nëntor, Dhjetor 2012, dhe Janar, Shkurt 2013, ndërsa në baza tremujore Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) TM3 dhe TM4 2012, dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) TM3 dhe TM4 2012;
- Janë bërë 5 publikime për Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin Tetor, Nëntor, Dhjetor 2012, Janar dhe Shkurt 2013 si dhe Bilanci i Energjisë TM2, TM3 dhe TM4 2012;
- Në fushën e Statistikave Sociale, janë zhvilluar 10 publikime dhe procese: Përgatitja e të dhënave preliminare për TM1 dhe të TM2 të Anketës së Fuçisë Punëtore (AFP), për vitin 2012 si dhe përpunimi i të dhënave për TM3 dhe TM4 të AFP, për vitin 2012; Përpunimi i të dhënave të Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2012; Përgatitja e draftit preliminar të statistikave të mirëqenies sociale për vitin 2012; Përgatitja e draftit preliminar të statistikave të sportit për vitin 2011; Statistikat e Mirëqenës Sociale TM3-2012; rezultatet finale të indikatorëve të tregut të punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012; vlerësimi i popullsisë i vitit 2011, vlerësimi i popullsisë i vitit 2012, popullsia sipas gjinisë, sipas etnicitetit dhe sipas vendbanimit;
- Në fushën e Statistikave të bujqësisë, janë të zhvilluar 7 publikime dhe procese: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, TM4-2012; Indeksi tremujor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, TM4-2012; Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, 2005 - 2012, (2005 = 100); Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, 2005 - 2012, (2005 = 100). Si dhe llogaritjet ekonomike në bujqësi 2010-2011, anketa e mbeturinave industriale 2011 dhe Anketa e mbeturinave komunale 2011;
- Është përgatitur një draft preliminar statistikor mbi korrupsionin dhe krimin ndaj bizneseve në Kosovë për vitin 2012 (Projekt i mbështetur nga UNDOC);
- Raporti preliminar gratë dhe burrat në Kosovë i vitit 2010 dhe 2011.

Përgatitja e draft raportit preliminar mbi Statistikat e jurisprudencës për personat madhor për vitin 2012.

### **3.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria**

#### **3.3.1. Azili, migrimi, politika e vizave dhe sundimi i ligjit**

Në lidhje me marrëveshjet bilaterale në fushën e azilit dhe migrimit në tetor 2012 u përfundua marrëveshja për riatdhesim ndërmje Republikës së Kosovës dhe Maltës.

Lidhur me procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar, që nga fillimi i vitit 2013, janë marrë këto vendime: 39 vendime për plane biznesi, 7 vendime për ndërtime dhe 5 riparime.

Sa i fushatave të vetëdijësimit të qytetarëve lidhur me migracionin e parregullt, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Integrimit Evropian kanë lansuar fushata gjatë periudhës raportuese. Billborde janë publikuar dhe mesazhe në TV dhe radio janë transmetuar në të gjithë vendin në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe turqisht).

Në fushën e MIK-ut, në kuadër të 10 marrëveshjeve ekzistuese, Dogana gjatë kësaj periudhe ka shkëmbyer korrespondenca ndërkombëtare me administratat tjera doganore. Si rezultat 25 kërkesa për verifikim të pranuar nga administratat tjera dhe 19 kërkesa për verifikim janë dërguar tek administratat tjera.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të kufirit, FRONTEX ka paralajmëruar vizitën në Kosovë për muajin maj 2013.

Sa i përket ngritjes së sigurisë së dokumentave, linja e njoftimit direkt nga PK tek ARC për dokumentet e humbura/vjedhura është vendosur, ndërsa baza e të dhënave e regjistrimit civil dhe gjendjes civile tashmë është integruar. Deri më tani janë digjitalizuar 1,034,342 të dhëna ose 2,405 libra të gjendjes civile të skanuara në Kosovë.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve institucionale, Komisionet Komunale për Riintegrim janë të themeluara dhe aktive në të gjitha komunat, ndërsa ToR për Departamentin e Riintegrimit janë hartuar gjatë shkurtit 2013. Sistemi elektronik për menaxhimin e rasteve është funksionalizuar ndërsa DSHAM ka themeluar dhe funksionalizuar bazën e vet të të dhënave e cila i ofron mundësinë që të lidhet me bazat e të dhënave dhe sistemet e tjera, të tilla si regjistri civil.

Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së pikë-kalimeve kufitare është bërë renovimi i Stacionit të Togjeve Patrulluese në Hanin e Elezit, ndërtimi në PKK Merdarë është përfunduar dhe është bërë vendosja e kontejnerëve ku ka pasur nevojë. Në PKK Bërnjak është bërë vendosja e kontejnerëve, ndërsa në PKK Mutivode është bërë vendosja e kontejnerëve dhe ndërtimi i rrugës.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve njerëzore, gjatë muajit shkurt 2013 janë mbajtur dy trajnime nga CREA-KO dhe ICITAP për punëtorët e DSHAM në lidhje me shfrytëzimin e databazës së DSHAM-it. Gjatë muajit prill 2013, është mbajtur trajnim dy ditor me temën "Cikli i Zhvillimit të Politikave" organizuar nga ICITAP ku janë certifikuar dy (2) zyrtarë nga DSHAM. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur trajnime për Kodin e Etikës, Anti-korrupsion dhe mbrojtje të të dhënave për të gjithë zyrtarët e përfshirë në ofrimin e shërbimeve të gjendjes civile dhe regjistrimit civil në nivelin qendror dhe atë lokal. Për më tepër, trajnime janë ofruar në lidhje me në lidhje me perdorimin e Regjistrimit Qëndror të Gjendjes Civile. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese IGJK-ja ka organizuar trajnime për 11 gjyqtarë për çështje të lidhura me azilin.

Me qëllim të ndjekjes më efektive të krimit të organizuar ndër-kufitar, në janar 2013 Njësia K9 është përforcuar me 18 qej, 6 nga të cilët janë të specializuar për detektimin e drogave, 6 në detektimin e armëve dhe 6 të tjerë për patrollim.

### **3.3.2. Shpërlarja e parave**

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Projektligjin për Plotësim-Ndryshim të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit më 11 shkurt 2013. Për më shumë, Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Shpërlarjes së Parave u aprovua në fund të vitit 2012.

NJIF e ka nënshkruar një marrëveshje me Policinë e Kosovës në shkurt 2013 në mënyrë që të rritet efikasiteti i këtij institucioni.

Nga 1 janari 2013 deri më 31 mars 2013 janë hapur 34 raste në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, nga këto raste 18 janë percjellur si informata të inteligjencës tek institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Poashtu, brenda kësaj periudhe NJIF u është përgjigjur 30 kërkesave për informata të cilat i ka percjellur në formë të raporteve si përgjigje në kërkesa institucioneve të ndryshme të zbatimit të ligjit vendor e ndërkombetar.

Gjatë periudhës janar-mars 2013, gjithsejt 6 zyrtarë të NJIF kanë marrë pjesë në shtatë (7) trajnime. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në luftimin e shpërlarjes së parave, zyrtarët nga Departamenti për Hetimin e Krimieve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e Kosovës për tre mujorin e parë të vitit 2013 kanë marrë pjesë në keto seminare: Seminarin për "Konfiskim te aseteve", Seminari për "Shpërlarje të parasë", Seminari për "Financim të terrorizmit" të organizuara nga Departamenti i Trajnimeve të PK-së dhe Zyra e Thesarit Amerikan. Për më shumë 8 gjyqtarë të Gjykatës Supreme kanë marrë pjesë në trajnimin "Agjenda Shoqëritë Tregtare Cikli i dytë" në fushën e luftimit të shpërlarjes së parave. Gjatë vitit 2012, katër prokurorë të shtetit kanë marrë pjesë në katër trajnime të specializuara në fushën e luftimit të shpërlarjes së parasë. Për më tepër janë mbajtur tri trajnime dy-ditore dhe një trajnim një-ditor lidhur me Legjislacioni Tatimor dhe Procedurat me gjithsejt 30 pjesëmarrës (19 gjyqtarë, 10 prokurorë dhe 1 bashkëpunëtor profesional).

### **3.3.3. Policia dhe Lufta Kundër Krimin të Organizuar**

Me qëllim të adresimit të prioritetëve në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimin të organizuar, gjatë periudhës raportuese kanë hyrë në fuqi këto akte legjislative:

- Ligji nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 shkurt 2013);
- Kodi i ri Penal (ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, dhe i cili i jep një hapësirë të veçantë terrorizmit, si pjesë e 11 neneve në kuadër të kapitullit mbi veprat penale kundër rendit kushtetues);
- Ligji i plotësuar-ndryshuar për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (miratuar më 11 shkurt 2013);
- UA për Ndërrimin e Identitetit të Personit të Mbrojtur;
- UA për Menaxhimin e Fondit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve miratuar në shtator 2012.

Përveç kësaj, më 8 janar 2013 është nënshkruar marrëveshja në mes të MBP-së dhe EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Sa u përket politikave, në janar 2013 është miratuar Strategjia dhe PV për Parandalimin e Krimin, ndërsa në shkurt 2013 janë miratuar Strategjia dhe PV mbi Policimin e Udhëhequr nga Inteligjenca si dhe Strategjia dhe PV për armët e vogla, dhe MPB ka draftuar raportin për implementimin e Strategjisë kundër terrorizmit 2012-2017.

Bashkëpunimi me EULEX-in ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur dy takime të Bordit të Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit (në nëntor dhe në mars). Për më tepër, Policia e Kosovës ka ftuar EULEX-in për të monitoruar procesin e gradimeve dhe emërimeve.

Gjatë periudhës raportuese, në Drejtorinë e PK-së për Krime Ekonomike dhe korrupsion janë rekrutuar pesë (5) zyrtarë shtesë. Për më tepër, Divizioni për Krim të Organizuar ka emëruar një zyrtarë shtesë, mandati i të cilit është për të mirëmbajtur rrjetin e brendshëm.



Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve teknike ose hetimin e narkotikëve, Drejtoria e PK-së Kundër Trafikimit me Narkotikë është pajisur me këto pajisje: 3 pajisje për testimin fushor të narkotikëve (minilaboratorë), 2 video digjitale, 4 kamera digjitale, 6 audio-regjistruar, 14 kompjuterë dhe 3 aparate fotokopjuese me printer. Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar është pajisur me pajisje të ndryshme për video-incizime dhe 6 kompjuterë të rinj.

Sa i përket përkushtimit në arritjen e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duke përfshirë hetimet, Drejtoria e PK-së për Hetimin e Krimit të Organizuar ka përfunduar katër (4) raste hetimi, janë arrestuar 15 të dyshuar dhe janë realizuar nëntë (9) operacione të ndryshme.

Statistikat e KPK-se janë të prezeatuara në tabelat në vijim:

**Tabela 13. Statistikat e KPK-së për krim të organizuar, 2012**

|      | Aktakuzat | Të dyshuar | Gjendja aktuale e procedurës |    |                |    |
|------|-----------|------------|------------------------------|----|----------------|----|
| 2012 | 39        | 248        | Të zgjidhura                 | 20 | Të pazgjidhura | 19 |
| 2013 | 26        | 121        | Të zgjidhura                 | /  | Të pazgjidhura | 26 |

**Tabela 14. Statistikat e KPK-së për keqpërdorim të detyrës zyrtare, 2012**

|      | Aktakuzat | Të dyshuar | Gjendja aktuale e procedurës |     |                |     |
|------|-----------|------------|------------------------------|-----|----------------|-----|
| 2012 | 643       | 1,760      | Të zgjidhura                 | 366 | Të pazgjidhura | 277 |
| 2013 | 424       | 1,210      | Të zgjidhura                 | 71  | Të pazgjidhura | 353 |

Gjatë vitit 2012, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka trajtuar katër (4) raste të terrorizmit. Ndaj 10 personave janë ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 4 personave janë duke u zhvilluar hetimet.

Sa i përket bashkëpunimit policor ndërkombëtar, numri i informacioneve të shkëmbyera për rastet me trafikim me narkotike dhe trafikim me armë është 74, ndërsa për krime ekonomike janë shpërndarë 33 informata. Gjatë kësaj periudhe, përmes Njesisë Koordinuese Ndërkombëtare për Zbatimin e Ligjit (ILECU), në kuadër të PK-së, janë shkëmbyer 24 informata, 10 prej tyre përmes ST mesazheve dhe 14 informata kanë qenë informata kthyes lidhur me rastet.

Janë zhvilluar dy operacione të përbashkëta me Policinë dhe Prokurorinë e EULEX-it për raste në nivelin ndërkombëtar. Gjithashtu hetime të përbashkëta janë zhvilluar me Gjermaninë, Austrinë, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë. Policia Kufitare dhe Doganat kanë zhvilluar shtatë (7) operacione të përbashkëta, që kanë rezultuar në konfiskimin e 18.833 kg marihuana.

Me qëllim të specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për luftimin e krimit të organizuar, gjatë vitit 2012 nëntë (9) prokurorë kanë marr pjesë në 5 trajnime të specializuara për luftimin veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore.

Sa i përket ngritjes dhe avancimit të kapaciteteve institucionale, 4 zyrtarë policor kanë marr pjesë në trajnimin për vendimmarrje të mbajtur në shtator 2012, kurse në ushtrimin fushor me Republikën e Shqipërisë dhe Malit të Zi, të mbajtur në tetor 2012, kanë marr pjesë pesë (5) zyrtarë policore. Sa i përket ngritjes dhe avancimit të kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me abuzim narkotike, trafikimit me arme dhe krimeve ekonomike janë mbajtur gjithsejtë 28 trajnime në të cilat janë trajnuar 74 zyrtarë policorë. Për më tepër, gjatë tremujorit të parë 2013,

për hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar janë mbajtur tri (3) trajnime të ndryshme, ku kanë marrë pjesë 8 zyrtarë policorë.

IGJK ka ofruar trajnimet në vijim për gjyqtarë, prokurorë dhe akterët tjerë në qështjet lidhur me krimin e organizuar:

**Tabela 15. Trajnimet e ofruara nga IGJK në fushën e krimit të organizuar**

| Tema  | Gjyqtarë | Prokurorë | Të tjera | Totali |
|---|----------|-----------|----------|--------|
| Krimi i organizuar  | 10       | 1         | 0        | 11     |
| Bashkëpunimi ndërkombtarë- krimi i organizuar dhe korrupsioni | 3        | 4         | 7        | 14     |
| Krimet e rënda  | 23       | 13        | 1        | 37     |
| Krimi kibernetik  | 9        | 2         | 0        | 11     |
| Dëshmitarë e mbrojtur në gjykata                              | 10       | 3         | 0        | 13     |
| Bashkëpunimi ndërkombtarë për qështjet kriminale              | 6        | 2         | 0        | 8      |
| Krimet e luftë  | 5        | 0         | 0        | 5      |
| Totali  | 66       | 25        | 8        | 99     |

### **3.3.4. Mbrojtja e të dhënave Personale**

Me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore për mbrotjen e të dhënave personale, ASHMDHP ka miratuar rregulloret për mirembajtjen e regjistrit të dosjeve të të dhënave personale (dhjetor 2012) dhe listën e shteteve antare te BE-se me nivel të kënaqshem për mbrotjen e të dhënave personale ( tetor 2012). Gjatë shtatorit 2012- janar 2013, ASHMDHP ka lëshuar 36 vendime për qështjet e të dhënave personale. Me qëllim të ngritjes së vetëdijës për mbrotjen e të dhënave personale, ASHMDHP ka mbajtur puntori për sektorin banker ( shtator 2012-prill 2013). Për më tepër nga 10 - 14 dhjetor 2012 jane mbajtur puntori për mbrotjen e të dhënave personale për 700 shërbyes civil ë punojnë me qështjet e regjistrimit civil në nivelin local dhe qendor

**Aneksi 1. Lista e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës per periudhen raportuese:**

|     |   |          |            |   |
|-----|---|----------|------------|---|
| 1.  | Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Kredi dhe Projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria për Financa, dhe Bankës Gjermane KfW lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj | 04/L-132 | 06.09.2012 | Dekreti nr. DL- 043 - 2012, Datë 28.09.2012 |
| 2.  | Ligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve  | 04/L-117 | 06.09.2012 | Dekreti nr. DL- 040 - 2012, Datë 19.09.2012 |
| 3.  | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-200 për grevat  | 04/L-119 | 06.09.2012 | Dekreti nr. DL- 041 - 2012, Datë 19.09.2012 |
| 4.  | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji  | 04/L-124 | 06.09.2012 | Dekreti nr. DL- 042 - 2012, Datë 19.09.2012 |
| 5.  | Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë  | 04/L-148 | 07.09.2012 | Dekreti nr. DL- 039 - 2012, Datë 07.09.2012 |
| 6.  | Ligji për bujqësi organike  | 04/L-085 | 13.09.2012 | Dekreti nr. DL- 046 - 2012, Datë 28.09.2012 |
| 7.  | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural  | 04/L-090 | 13.09.2012 | Dekreti nr. DL- 044 - 2012, Datë 28.09.2012 |
| 8.  | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore   | 04/L-118 | 13.09.2012 | Dekreti nr. DL- 045 - 2012, Datë 28.09.2012 |
| 9.  | Ligji për komunikimet elektronike   | 04/L-109 | 12.10.2012 | Dekreti nr. DL- 047 - 2012, Datë 25.10.2012 |
| 10  | Ligji për mbrojtjen e konsumatorit  | 04/L-121 | 19.10.2012 | Dekreti nr. DL- 049 - 2012, Datë 07.11.2012 |
| 11. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082  | 04/L-129 | 19.10.2012 | Dekreti nr. DL- 048 - 2012, Datë 02.11.2012 |
| 12. | Ligji për rritjen e Kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar  | 04/L-152 | 01.11.2012 | Dekreti nr. DL- 050 - 2012, Datë 09.11.2012 |
| 13. | Ligji për Ratifikimin e Amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv   | 04/L-153 | 01.11.2012 | Dekreti nr. DL- 051 - 2012, Datë 09.11.2012 |
| 14. | Ligji për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme   | 04/L-136 | 05.11.2012 | Dekreti nr. DL- 052 - 2012, Datë 14.11.2012 |
| 15. | Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës   | 04/L-144 | 22.11.2012 | Dekreti nr. DL- 053 - 2012, Datë 04.12.2012 |

|     |   |          |            |  |
|-----|---|----------|------------|--|
| 16. | Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë      | 04/L-166 | 06.12.2012 | Dekreti nr. DL- 054 - 2012, Datë 11.12.2012  |
| 17. | Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"   | 04/L-086 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 60 -2012, Datë 26.12.2012  |
| 18. | Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri"  | 04/L-087 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 059 - 2012, Datë 26.12.2012  |
| 19. | Ligji për mbrojtjen e bimëve  | 04/L-120 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 064 - 2012, Datë 28.12.2012  |
| 20. | Kodi i procedurës penale  | 04/L-123 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 057 - 2012, Datë 21.12.2012  |
| 21. | Ligji për shëndetësi  | 04/L-125 | 13.12.2012 |  |
| 22. | Ligji për regjistrimin e bujqësisë  | 04/L-127 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 063 - 2012, Datë 27.12.2012  |
| 23. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë | 04/L-133 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 62 -2012, Datë 27.12.2012  |
| 24. | Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës   | 04/L-143 | 13.12.2012 | Shpallur, në pajtim me nenin 80.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, datë, 08.01. 2013 |
| 25. | Ligji për punimet nga metalet e çmuara  | 04/L-154 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 061 - 2012, Datë 27.12.2012  |
| 26. | Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013   | 04/L-165 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 056 - 2012, Datë 17.12.2012  |
| 27. | Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim   | 04/L-169 | 13.12.2012 | Dekreti nr. DL- 055 - 2012, Datë 13.12.2012  |
| 28. | Ligji për procedurën përmbartimore  | 04/L-139 | 20.12.2012 | Dekreti nr. DL- 001 - 2013, Datë 03.01.2013  |
| 29. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat  | 04/L-171 | 20.12.2012 | Dekreti nr. DL- 058 - 2012, Datë 21.12.2012  |
| 30. | Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale   | 04/L-140 | 11.02.2013 | Dekreti nr. DL- 002 - 2013, Datë 26.02.2013  |
| 31. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit         | 04/L-178 | 11.02.2013 | Dekreti nr. DL- 003 - 2013, Datë 26.02.2013  |
| 32. | Ligji për zonat ekonomike   | 04/L-159 | 14.02.2013 | Dekreti nr. DL- 005 - 2013, Datë 04.03.2013  |

|     |   |          |            |   |
|-----|---|----------|------------|---|
| 33. | Ligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil  | 04/L-160 | 14.02.2013 | Dekreti nr. DL- 004 - 2013, Datë 04.03.2013 |
| 34. | Ligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor                 | 04/L-163 | 14.02.2013 |   |
| 35. | Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional   | 04/L-138 | 28.02.2013 | Dekreti nr. DL- 006 - 2013, Datë 18.03.2013 |
| 36. | Ligji për Avokaturën Shtetërore   | 04/L-157 | 12.03.2013 | Dekreti nr. DL- 008 - 2013, Datë 26.03.2013 |
| 37. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës                  | 04/L-168 | 12.03.2013 | Dekreti nr. DL- 007 - 2013, Datë 26.03.2013 |
| 38. | Ligji për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës                                       | 04/L-146 | 19.03.2013 | Dekreti nr. DL- 009 - 2013, Datë 05.04.2013 |
| 39. | Ligji për ujërat e Kosovës  | 04/L-147 | 19.03.2013 | Dekreti nr. DL- 011 - 2013, Datë 05.04.2013 |
| 40. | Ligji për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme   | 04/L-183 | 19.03.2013 | Dekreti nr. DL- 010 - 2013, Datë 05.04.2013 |
| 41. | Ligji për veprimtari kërkimore-shkencore  | 04/L-135 | 28.03.2013 |   |
| 42. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale                         | 04/L-158 | 28.03.2013 |   |
| 43. | Ligji për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për ansamblet e tjera                       | 04/L-164 | 28.03.2013 |   |
| 44. | Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve         | 04/L-189 | 28.03.2013 |   |
| 45. | Ligji për sistemin e pagesave   | 04/L-155 | 04.04.2013 |   |
| 46. | Ligji për kontrollin e duhanit  | 04/L-156 | 04.04.2013 |   |
| 47. | Projektligji për Turizmin   | 04/L-176 | 11.04.2013 |   |
| 48. | Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut | 04/L-186 | 11.04.2013 |   |

**Aneksi 2: Projektligjet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës për periudhën raportuese:**

| Nr  | Emërtimi i Projektligjit   | Data e miratimit në Qeverinë e Kosovës | Data e dërgimit në Kuvend | Data e Miratimit të parë(I). | Data E Miratimit të dytë(II).  |
|-----|--|--|---------------------------|------------------------------|--|
| 1.  | P/Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjeve për Sundim të Ligjit BE-në (ZKM)   | 05.09.2012                             | 05.09.2012                | 07.09.2013                   | 06.09.2012   |
| 2.  | P/ligji për Sistemin e Pagesave(MF)  | 05.09.2012                             | 18.09.2012                | 05.11.2013                   | 04.04.2013   |
| 3.  | P/Ligji për Avokaturën Shtetërore(MD)  | 14.09.2012                             | 24.09.2012                | 04.04.2013                   | 12.03.2013   |
| 4.  | P/Ligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil(MPB)  | 04.10.2012                             | 10.10.2012                | 14.02.2013                   | 14.02.2013   |
| 5.  | P/ligji për Zonat Ekonomike(MTI)   | 04.10.2012                             | 10.10.2012                | 14.02.2013                   | 14.02.2013   |
| 6.. | P/Ligji për Investimet e huaja(MTI)  | 10.10.2012                             | 15.10.2012                | 14.02.2013                   | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Zhvillim Ekonomik                      |
| 7.  | P/ligji për Sigurinë dhe mbrojtën në Punë(MPMS)  | 10.10.2012                             | 15.10.2012                | 14.02.2013                   | Është në procedurë parlamentare Komisioni për shëndetësi , punë dhe mirëqene sociale |
| 8.  | P/Ligji për Ansamblin Kombëtar të këngëve dhe Valleve Shota(MKRS)  | 17.10.2012                             | 29.10.2012                | 28.03.2013                   | 28.03.2013   |
| 9.  | P/Ligji për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero(MF)  | 17.10.2012                             | 25.10.2012                | 14.02.2013                   | 14.02.2013   |
| 10. | P/Ligji për Ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Austrisë(MF) | 17.10.2012                             | 30.10.2012                |                              | 06.12.2012   |
| 11. | P/Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës(MF)   | 29.10.2012                             | 30.10.2012                | 13.12.2012                   | 13.12.2013   |
| 12. | P/Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës(ZKM)   | 12.11.2012                             | 16.11.2012                | 19.03.2013                   | Është në procedurë parlamentare Komisioni për  |

|     |   |            |            |            | Legjislacion   |
|-----|---|------------|------------|------------|--|
| 13. | P/Ligji për transplantimin e organeve(MSH)  | 14.11.2012 | 23.11.2012 | 24.01.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni përshëndetësi , punë dhe mirëqene sociale              |
| 14. | P/Ligji për N.P.e Ligjit për Gjykatat(MD)   | 19.11.2012 | 23.11.2012 | 20.12.2012 | 20.12.2012   |
| 15. | P/Ligji për përgjimet e telekomunikimeve (ZKM)  | 03.12.2012 | 23.11.2012 |            | Është në procedurë parlamentare Komisioni për shëndetësi , punë dhe mirëqene sociale             |
| 16. | P/Ligji për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtimi (MF)                  | 03.12.2012 | 23.11.2012 | 13.12.2012 | 13.12.2012   |
| 17. | P/Ligji për n.p. e Ligjit nr.03/L196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin të terrorizmit(MF) | 03.12.2012 | 13.12.2012 | 31.12.2012 | 11.02.2013   |
| 18. | P/Ligji për Planifikim hapësinor (MMPH)   | 07.12.2012 | 12.12.2012 | 01.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Bujqësi Pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor |
| 19. | P/Ligji për Inspektoratin e Mjedisit,Ujërave Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (MMPH)                      | 07.12.2012 | 12.12.2012 | 31.01.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Bujqësi Pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor |
| 20. | P/Ligji për Turizmin(MTI)   | 07.12.2012 | 12.12.2012 | 14.02.2013 | 13.04.2013   |

|     |   |            |            |            |   |
|-----|---|------------|------------|------------|---|
| 21. | P/Ligji për Transportin Rrugor(MI)                            | 07.12.2012 | 12.12.2012 | 31.01.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Zhvillim Ekonomik                               |
| 22. | P/Ligji për dërgimin e FSK-n Kosovës jashtë vendit (MFS)      | 07.12.2012 | 12.12.2012 | 31.01.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të FSK |
| 23. | P/ligji për Investimet e huaja(MTI)                           | 14.12.2012 | 19.12.2012 | 14.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Zhvillim Ekonomik                               |
| 24. | P/Ligji për Produktet e Ndërtimit(MTI)                        | 14.12.2012 | 19.12.2012 | 14.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Zhvillim Ekonomik                               |
| 25. | P/Ligji për Institutin e Administratës Publike(MAP)           | 14.12.2012 | 19.12.2012 | 01.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Arsim dhe Administratë Publike                  |
| 26. | P/Ligji për transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme(MI) | 14.12.2012 | 19.12.2012 | 01.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Zhvillim Ekonomik                               |
| 27. | P/Ligji për Administrimin e Punës në Zyrë(MAP)                | 14.12.2012 | 19.12.2012 | 01.02.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Arsim dhe Administratë Publike                  |
| 28. | P/Ligji për trajtimet e ndërtimeve pa leje (MMPH)             | 26.12.2012 | 28.12.2012 | 19.03.2013 | Është në procedurë  |



|     |  |            |            |            |   |
|-----|--|------------|------------|------------|---|
|     |  |            |            |            | parlamentare<br>Komisioni për<br>Bujqësi  |
| 29. | P/Ligji për N.P. e Ligjit për<br>Inspektoratin dhe<br>Mbikëqyrjen e Tregut (MTI)   | 26.12.2012 | 28.12.2012 | 14.02.2013 | 11.04.2013  |
| 30. | P/Ligji për treguesit<br>Gjeografik(MTI)   | 26.12.2012 | 28.12.2012 | 14.03.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare<br>Komisioni për<br>Zhvillim<br>Ekonomik                            |
| 31. | P/Ligji për tarifat e veçanta të<br>akcizës në prodhimin e<br>alkoolit (MF)  | 26.12.2012 | 28.12.2012 | 01.02.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare<br>Komisioni për<br>Buxhet  |
| 32. | P/Ligji për ndryshimin dhe<br>plotësimin e Ligjit nr. 04/L-<br>078 për sigurinë e<br>përgjithshme të produkteve<br>(MTI) | 09.01.2013 | 16.01.2013 | 19.03.2013 | 28.03.2013  |
| 33. | P/ligji për pajisjet<br>medicinave(MSH)  | 30.01.2013 | 06.02.2013 | 19.03.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare<br>Komisioni për<br>shëndetësi ,<br>punë dhe<br>mirëqene<br>sociale |
| 34. | P/ligji për Blegtorin<br>(MBPZHR)  | 30.01.2013 | 06.02.2013 | 19.03.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare<br>Komisioni për<br>shëndetësi ,<br>punë dhe<br>mirëqene<br>sociale |
| 35. | P/Ligji për Transplantimin e<br>Indeve dhe Qelizave(MSH)   | 17.02.2013 | 27.02.2013 | 28.03.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare<br>Komisioni për<br>shëndetësi ,<br>punë dhe<br>mirëqene<br>sociale |
| 36. | P/Ligji për Avokatinë(MD)  | 27.02.2013 | 20.03.2013 | 27.03.2013 | Është në<br>procedurë<br>parlamentare   |

|     |  |            |            |            |  |
|-----|--|------------|------------|------------|--|
|     |  |            |            |            | në Komisionin për Legjislacion   |
| 37. | Projektligji për Tregunë e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë (MTI) | 27.03.2013 | 30.03.2013 | 12.04.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për shëndetësi , punë dhe mirëqene sociale |
| 38. | Projektligji për menaxhimin e Financave Publike(MF)                        | 27.03.2013 | 30.03.2013 | 28.04.2013 | Është në procedurë parlamentare Komisioni për Buxhet                                 |

### **Aneksi 3: Legjislacioni sekondar qe eshte miratuar ne Qeverine e Republikes se Kosoves per periudhen raportuese**

- RREGULLORE NR. 20/2012 PËR PUNËN VULLNETARE TË NËPUNËSVE CIVIL PAS PENSIONIMIT 15.10.2012
- RREGULLORE NR. 21/2012 PËR AVANCIMIN NË KARRIERË TË NËPUNËSVE CIVILË 15.10.2012
- RREGULLORE NR. 22/2012 PËR PËRCAKTIMIN E KUALIFIKIMEVE TË VEÇANTA, SHPËRBLIMIN1 DHE KOMPENSIMIN DHE PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT TË ADMINISTRATORËVE FALIMENTUES 17.10.2012
- RREGULLORE NR. 23/2012 PËR KOMISIONIN QEVERTAR PËR NJOHJEN DHE VERIFIKIMIN E STATUSIT TË DËSHMORIT TË KOMBIT, INVALIDIT, VETERANIT, PJESËTARIT APO TË INTERNUARIT TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS 17.10.2012
- RREGULLORE NR. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA 05.11.2012
- RREGULLORE NR. 25/2012 PËR NORMAT TEKNIKE TË MBROJTJES NGA ZJARRI NË NDËRTIMIN E IMPIANTEVE PËR LËNGJET E NDEZSHME, DEPONIMIN DHE TOÇITJEN E TYRE 05.11.2012
- RREGULLORE Nr. 26/2012 E PUNËS SË KOMISIONIT QEVERTAR PËR TË DREJTAT E ISH TË BURGOSURVE, TË ISH TË DËNUARVE E TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË 03.12.2012
- RREGULLORE NR.27/2012 PËR KRITERET MIKROBIOLOGJIKE NË PRODUKTET USHQIMORE 11.12.2012
- RREGULLORE NR. 28/2012 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË 11.12.2012
- RREGULLORE NR.29/2012 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRIËSË 14.12.2012
- RREGULLORE NR. 30/2012 PËR KUSHTET E KUFIZIMIT TË SE DREJTËS PËR GREVE NË SHËRBIME TË VEÇANTA NË SHËRBIMIN CIVIL 14.12.2012

- RREGULLORE NR. 31/2012 PËR PROCEDURAT E PËRKUJDESJES PËR NËPUNËSIT CIVIL PËR SHKAK TË PAAFTËSISË FIZIKE APO MENDORE OSE PROBLEMEVE SHËNDETËSORE 14.12.2012
- RREGULLORJA NR. 32/2012 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË MINISTRINË E INTEGRIMIT EVROPIAN 24.12.2012
- RREGULLORE NR. 33/2012 PËR SHITESAT NË PAGË DHE KOMPENSIME TË TJERA TË NËPUNËSVE CIVILË 24.12.2012
- RREGULLORE NR. 34/2012 PËR PAGESËN E PAGAVE DHE SHITESAVE TË KRYETARËVE/KRYESUESVE DHE TË ANËTARËVE TË BORDIT PËR RISHQYRTIMIN E ANKESAVE, KOMITETEVE TË AUDITIMIT, KËSHILLIT KOSOVAR PËR RAPORTIM FINANCIAR 27.12.2012
- RREGULLORE NR. 37/2012 PËR ANKESAT NË PROCEDURËN E VERIFIKIMIT 10.01.2013
- RREGULLORE NR. 38/2012 PËR PLANIFIKIMIN E TRAJNIMEVE DHE KOORDINIMIN E DONACIONEVE PËR TRAJNIMET E INSTITUCIONEVE TE SIGURISË PUBLIKE TË CILAT ORGANIZOHEN DHE MBAHEN NË AKSP 10.01.2013
- RREGULLORE NR. 39/2012 PËR KODIN E ETIKËS NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE 10.01.2013
- RREGULLORE NR. 40/2012 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR MINISTRINË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM 10.01.2013
- RREGULLORE NR. 01/2013 PËR RIORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS SË AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS 31.01.2013
- RREGULLORE NR.02/2013 MBI KRITERET PËR KRIJIMINE NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE DHE PJSËMARRJA E KOMUNAVE NË BORDET E DREJTORËVE TË NDËRMARRJEVE RAJONALE TË UJIT
- RREGULLORE NR. 03/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL 12.02.2013
- RREGULLORE NR. 04/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME 12.02.2013
- RREGULLORE NR. 05/2013 PËR NDËRMJETËSIM TË KONTESTEVE NË FUSHËN E TË DREJTËS SË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA NË MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT 12.02.2013
- RREGULLORE NR. 06/2013 PËR BORDIN E AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE 06.03.2013
- RREGULLORE NR. 07/2013 PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E KOMPENSIMIT TË ISH TË DËNUAREVE POLITIKË 14.03.2013
- RREGULLORE Nr. 08/2013 PËR PËRMBAJTJEN DHE PROCEDURAT E HARTIMIT TË PLANEVE TË REAGIMIT EMERGJENT 04.04.2013
- RREGULLORE NR.09/2013 PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL 04.04.2013
- RREGULLORE NR. 10/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË TREGUT 04.04.2013
- UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2013 PËR STEMËN E AGJENCISË SË MENAXHIMIT EMERGJENT 06.03.2013
- UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2013 PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË NDIHMËS ORGANEVE QEVERITARE NGA POLICIA E KOSOVËS 11.03.2013

#### **Aneksi IV - Strategjite dhe planet e veprimit qe jane miratuar ne Qeverine e Republikes se Kosoves per periudhen raportuese:**

- Strategjia per Parandalimin e Shperlarjes se Parave dhe Financimin e Terrorizmit 12.09.2012;
- Strategjia Kombetare per Menaxhimin e Integraur te Kufirit Shtetror;
- Strategjia Kombetare Kunder Drogave dhe Plani I Veprimit per vitin 2012-2017;
- Strategjia kombetare Kunder Terrorizmit per vitin 2012-2017 dhe Plani i Veprimit
- Strategjia Kombetare Kunder Krimit te Organizuar dhe Plani i Veprimit per vitin 2012-2017;
- Strategjia Kombetare dhe Plani I veprimit per Parandalimin e Krimit 2013-2017;
- Strategjia kundër Falsifikimit dhe Piraterisë;
- Programi Pesevjeqar i Statistikave;
- Strategjia Kombetare per Rininë;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit per Parandalimin e Krimit;
- Strategjia per Decentralizimin e Sherbimeve Sociale;
- Strategjia per Zhvillimin e Sektorit Privat.

#### **Aneks 5: Udhezimet Administrative te aprovuara gjate periudhes raportuese ne fushen e arsimit:**

- UA - Nr. 11 - 2012 Kriteret për licencimin e Institucioneve arsimore private për nivelin fillor dhe te mesëm te larte dhe institucioneve aftësuese profesionale date:12.09.2012
- UA - Nr. 12/2012 Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktoreve për arsim gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre. Date: 18.09.2012
- UA - Nr. 13/2012 Pjesëmarrja financiare e nxënësve për SNKA niveli 4. date: 18.09.2012
- UA - Nr. 14/2012 Testi pranues për shkolla te caktuara profesionale te nivelit 3 ISCED date: 18.09.2012
- UA - Nr. 15/2012 Përkujdesja për fëmijëri te hershme dhe arsimim date: 18.09.2012
- UA - Nr. 16/2012 Pjesëmarrja e nxënësve në tekstet shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre date: 18.09.2012
- UA - Nr. 17 / 2012 Numri maksimal i nxënësve për klase dhe raporti mësimdhënës - nxënës. Date: 18.09.2012
- UA - Nr. 18 / 2012 Pilotimi i Kornizës se kurrikules - kurrikules bërthame date: 04.10.2012
- UA - Nr. 19 / 2012 Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit ne arsimin e obliguar date: 04.10.2012
- UA - Nr. 20/ 2012 Krahasueshmeria dhe barasvlera e diplomave dhe programeve studimore para sistemit te Bilonjës dhe te sistemit te Bilonjës date; 22.10.2012
- UA - Nr. 21 / 2012 Aplikimi i pagesave te standardeve te Universitetit Publik date: 22.10.2012
- UA - Nr. 22 / 2012 Gradat dhe diplomat e bartësve te Arsimit te Larte date: 22.10.2012
- UA - Nr.24/ 2012 Kategoritë e standardeve për asistence si dhe kushtet për fitimin e asistencës date: 22.10.2012
- UA - Nr. 25/ 2012 Licencimi i bartësve Privat të Arsimit te Larte ne Kosove date: 22.10.2012
- UA - Nr. 26 / 2012 Kualifikimi për personelin qe punon me nxënësit me nevoja te veçanta arsimore 31.10.2012
- UA - Nr. 27 / 2012 Përfshirja dhe caktimi i numrit te nxënësve ne Institucionin e aftësimit ne nivelin e 4 te SNKA-se date 31.10.2012
- UA - Nr. 28/ 2012 Themelimi dhe funksionimi i këshillit te prindërve te Kosoves (KPK) date: 31.10.2012
- UA - Nr.29/ 2012 Themelimi i paraleleve te ndara 31.10.2012
- UA - Nr. 30 / 2012 Aktivitetet jashtëshkollore date 31.10.2012

- UA - Nr. 01/ 2013 Emërtimi I Institucioneve te Arsimit te Larte date: 16.01.2013
- UA - Nr. 02/2013 Mbi Akreditimin e Institucioneve te Arsimit te Larte ne Republikën e Kosovës date: 16.01.2013
- UA - Nr. 03/ 2013 Lëshimi i dokumenteve duplikate nga institucionet edukativo-arsimore dhe universitare date: 21.01.2013
- UA - Nr. 04/2013 Për verifikimin e te gjitha dokumenteve te te gjitha niveleve te shkollimit date: 21.01.2013
- UA - Nr. 05 / 2013 Zbatimi i Plan programeve për Arsimin Profesional - Lëmi: Agrobiznesi ne bujqësi: - Profili: Agrobiznes date: 23.01.2013
- UA - Nr. 06/2013 Zbatimi i plan programeve për arsimin profesional – Lëmi: Teknologji Ushqimore:- Profili: Përpunues i mishit date: 23.01.2013
- UA - Nr. 07/2013 Zbatimi i plan programeve për arsimin profesional – Lëmi: Teknologjia Ushqimore – Profili: Përpunues i qumështit date: 23.01.2013
- UA - Nr. 08/ 2013 Zbatimi i plan programeve për arsimin profesional – Lëmi: Teknologjia ushqimore – Profili: Përpunues i Frutave dhe Perimeve date: 23.01.2013
- UA - Nr. 09/2013 Zbatimi i plan programeve për arsimin profesional – Lëmi: Teknologji ushqimore – Profili: Furrta date: 23.01.2013
- UA - Nr. 10/2013 Zbatimi i plan programeve për arsimin profesional – Lëmi: Teknologji ushqimore – Profili: Kuzhinier date: 23.01.2013
- UA - Nr.11/ 2013 Verifikimi I diplomave dhe dokumentacionit tjetër te lëshuar nga BRaAL date: 04.03.2013
- UA - Nr. 12 / 2013 Mbajtja e zgjedhjeve ne Universitetin “Haxhi Zeka” te Pejës date: 08.04.2013